



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 21

Tiranë – E mërkurë, 18 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 2.2.2015	Mbi miratimin e marrëveshjes midis KESH sh.a. dhe OST sh.a. për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”, për vitin 2015..... 1111
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 2.2.2015	Për licencimin e shoqërisë “Fatlum” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Perrollaj” me fuqi të instaluar 0.5 MW..... 1115
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 3, datë 2.2.2015	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k. nga HEC “Përrollaj”, me fuqi 0.5 MW..... 1116
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 2.2.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Roberto Oil” sh.a., në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike..... 1116
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 2.2.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Roberto Oil” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... 1117
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 2.2.2015	Mbi kërkesën e OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 141, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “për përcaktimin e tarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015”..... 1118
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 2.2.2015	Për licencimin e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike..... 1118
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 2.2.2015	Për licencimin e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... 1119
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 4.2.2015	Mbi miratimin e marrëveshjes midis KESH sh.a. dhe OST sh.a. për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik..... 1120

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 4.2.2015	Për miratimin e “Marrëveshjes së shërbimit të transmetimit” të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për vitin 2015...	1130
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11, datë 4.2.2015	Për mbi miratimin e marrëveshjes për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSHEE sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për vitin 2015..	1138
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 12, datë 6.2.2015	Për miratimin e marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.....	1149



VENDIM
Nr. 1, datë 2.2.2015

**MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES
MIDIS KESH SHA DHE OST SHA PËR
SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E
HUMBJEVE TEKNIKE NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT”, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, dhe nenit 26, pika 1, nenit 35, pika 1, germa “b” dhe pika 2, germa “b”, si dhe neni 41, pika 3, germa “ç” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, pika 4.13, germa “a”, pika 8, pika 5.2, “ii” dhe pika 7, germa “f” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, kapitullit V të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, mbi kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit” për vitin 2015 ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OST sh.a.,

konstatoi se:

1. Palët e kësaj marrëveshjeje janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e marrëveshjes “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit” duke pasur parasysh që:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23 datë 23.6.2009, i ndryshuar.

- Shoqëria OST sh.a. është licencuar në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009.

2. Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit” për vitin 2015 ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OST sh.a., bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2015 deri në datën 31 dhjetor 2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KONTRATË
PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E
HUMBJEVE TEKNIKE NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT SHA
(më poshtë referuar si “OST” sh.a)
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga
“Viktor Eftimiu”, Tiranë
dhe
KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
(më poshtë referuar si KESH sh.a.)
Adresa: Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë
OST sh.a. dhe KESH sh.a. më poshtë
referuar si “palët”
Tiranë, 23.12.2014

Baza ligjore

Baza ligjore për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate është:

a) ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar);

b) ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”;

c) vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”;

d) Kodi i Rrjetit të Transmetimit, i miratuar dhe i ndryshuar me vendim të Bordit të



Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, vendim nr. 123, datë 24.10.2008;

e) rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 68, datë 23.6.2008 “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”;

f) vendimi nr. 24, datë 26.3.2009, me të cilin Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka rinovuar licencën për transmetimin e energjisë elektrike OST sh.a.;

g) vendimet nr. 23, datë 25.3.2009, nr. 10, datë 6.2.2014 dhe nr. 34, datë 13.5.2014, me të cilat Enti Rregullator i Energjisë (ERE), ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin, furnizimin publik me shumicë, dhe tregtimin e energjisë elektrike, KESH sh.a.;

h) vendimi nr. 77, datë 26.6.2008, me të cilin ERE ka miratuar metodologjinë e llogaritjes së tarifave për Kompaninë Publike të Prodhimit.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kontratë ose kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këto përkufizime:

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë dhe të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen kësaj kontratë së bashku me anekset dhe çdo dokumentacioni bashkëlidhur.

“Data e fillimit” do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të bëhet efektive.

“Muaji” do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00:00 të ditës së parë kalendarike të muajit dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit kalendarike të po atij muaji.

“Viti” do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00:00 të ditës së parë të vitit kalendarik dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit të po atij viti kalendarik

“OST sh.a.” është Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, i cili operon bazuar në licencën e dhënë nga ERE.

“KESH sh.a.” – Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, i cili operon bazuar në licencën e dhënë nga ERE.

“Palët” do të thotë OST sh.a. dhe KESH sh.a.

“ERE” – Enti Rregullator i Energjisë.

“Sistemi Elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga Centralet e Prodhimit të Energjisë Elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për Transmetimin dhe Shpërndarjen e Energjisë Elektrike të konsumatorët.

“Sistemi i Transmetimit” është një sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, që përdoren për transmetimin e energjisë elektrike.

“Humbjet teknike të energjisë elektrike” do të thotë humbjet teknike të një elementi të rrjetit, të cilat janë të barabarta me diferencën e energjisë elektrike që futet në këtë element me energjinë elektrike që del nga ky element.

“Përfaqësues i Autorizuar” është person i ngarkuar zyrtarisht nga përfaqësuesi ligjor i kompanive OST sh.a. dhe KESH sh.a. për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate.

“Çmimi” do të thotë çmimi i shit-blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, i vendosur nga Enti Rregullator i Energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

“Faturë” për efekt të kësaj kontrate me faturë do të kuptohet dokumenti shkresor (fatura tatimore), i cili përmban përcaktimet e bëra në nenin 5.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për skedulimin, deklarimin dhe garantimin në sasinë dhe cilësinë e kërkuar të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit, mënyrën e llogaritjes dhe faturimin e saj.

Neni 3

Lëvrimi dhe pranimi i energjisë elektrike

3.1 KESH sh.a. merr përsipër të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit për OST sh.a., në sasinë dhe kohën e kërkuar prej saj.

3.2 Kjo kontratë ka prioritet mbi të gjitha kontratat e tjera të shitjeve që bëhen nga KESH sh.a.

3.3 OST sh.a. merr përsipër të skedulojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit për OST sh.a.,



me bazë mujore, javore dhe ditore/orare, në përputhje me përcaktimet e dispozitave përkatëse të Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Skedulimet do të paraqesin vlerësimin më të mirë të nivelit të humbjeve teknike.

3.4 Lëvrimi i energjisë elektrike do të bëhet në dalje të zbarave ngritëse të transformatorëve që ndodhen në HEC-et Fierza dhe/ose Koman dhe/ose Vau i Dejës.

Neni 4

Çmimi

4.1 OST sh.a. paguan KESH sh.a. për energjinë elektrike të blerë për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, me çmimin të miratuar, nga ERE.

4.2 Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate është çmimi në fuqi i miratuar nga ERE.

4.3 Nëse ERE miraton një çmim të ndryshëm nga ai i aplikuar në këtë kontratë, palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasitë e faturuara në përputhje me vendimin përkatës së ERE-s.

Neni 5

Llogaritja/Matja, faturimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit

5.1 OST sh.a. do të përllogarisë, sipas procedurave të përcaktuara në Rregullat e Tregut dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit, sasinë e energjisë elektrike që i korrespondon humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, me bazë mujore dhe ia dërgon KESH sh.a. të evidentuar si zë në Bilancin Energjetik mujor, brenda datës 4 të muajit pasardhës ose në ditën e punës pasardhëse, nëse dita e 4-t e muajit korrespondon ditë zyrtare pushimi.

5.2 Menjëherë pas marrjes së Bilancit Energjetik, KESH sh.a., lëshon për OST sh.a., faturën tatimore përkatëse për sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit, sipas çmimit të miratuar me vendimin përkatës të ERE-s.

5.3 OST sh.a. do t'i kryejë pagesën KESH sh.a. kundrejt vlerave të faturave mujore përkatëse për energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve. Paga do të bëhet brenda ditës së 30 të muajit kalendarik në të cilin është lëshuar secila prej faturave nga KESH sh.a.

5.4 Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse OST sh.a. dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në pagimin e kamatëvonesës në masën e: Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje. Kamatëvonesa paguhet pa qenë i detyruar që KESH sh.a. të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa. Vlera totale e kamatëvonesave të aplikuara për çdo faturë nuk mund të kalojë vlerën e vetë faturës.

Neni 6

Mospërformanca për shkak të Forcës Madhore

6.1 Përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë kontratë, “Forca Madhore” për qëllimet e kësaj kontrate do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale që e pengon atë palë të realizojë disa ose të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Ngjarjet e forcës madhore do të përfshijnë pa kufizim:

a) Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë secilën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të një pale dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe që pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj, si dhe rastet e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 9072 të datës 22.4.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, (i ndryshuar).

6.2 Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për lëvrim dhe



pranim sipas kësaj kontrate dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 6.3 të këtij neni, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e palës pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhë kohore që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet (zhdëmtimet për paaftësinë për lëvrim dhe pranim) nuk do t'i kërkohej dhe merret palës lidhur me sasinë e palivruara respektivisht të pamarrë si rezultat i forcës madhore.

6.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi konstaton forcën madhore, pala që kërkon përjashtim nga detyrimet e veta, do të njoftojë palën tjetër për ngjarjen e forcës madhore dhe për atë sa është e mundur do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet ekonomike të favorshme dhe të ligjshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimet të forcës madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër të dhëna të përditësuara, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

Neni 7

Garancitë dhe mbështetja e kredisë

7.1 Shitësi dhe blerësi janë të detyruar të lëshojnë në kuadrin e kësaj kontrate përkatësisht:

Blerësi një garanci financiare dhe shitësi një garanci performance, sipas termave të mëposhtëm:

a) Garancia financiare: Për të mbuluar risqet e aftësisë pagueuse të blerësit ndaj shitësit lidhur me sasinë e energjisë elektrike të livruar për të siguruar plotësimin e menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të tjera që rezultojnë nga kjo kontratë, blerësi do të ketë ngurtësuar, 10 ditë kalendarike përpara muajit përkatës të livrimit, në favor të shitësit, garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon $\frac{1}{2}$ të sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar, e cila do të jetë e vlefshme deri në datën e fundit të muajit pasardhës të muajit të livrimit të energjisë me çmim shitjeje të përcaktuar sipas kësaj kontrate. Garancia bankare duhet të lëshohet nga një bankë e nivelit të dytë të licencuar në vend;

b) garancia e performancës: Në rast se shitësi dështon të përmbushë detyrimet e tij për livrimin

e energjisë elektrike sipas skedulit të paraqitur nga blerësi, për më shumë se tri ditë radhazi, atëherë Blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi vendosjen e një garancie performace në formën e një garancie financiare në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuar në vend, në vlerën që i korrespondon sasisë mesatare të energjisë elektrike të programuar në një javë (- GWh) me çmimin e blerjes të miratuar nga ERE.

Pas marrjes së njoftimit me shkrim, pala tjetër brenda tri (3) ditëve pune do t'i sigurojë palës kërkuar garancinë e kërkuar të performancës.

7.2 Ndryshimi i dëmshëm material: Një ndryshim i dëmshëm material do të ketë ndodhur nëse ka ndodhur një ose më shumë nga ngjarjet e specifikuar nga vete palët.

Neni 8

Zgjidhje e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

8.1 Për çdo gjë të pashprehur në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të legjislacionit që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.

8.2 Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me të gjitha aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8.3 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, përfaqësuesit e autorizuar për çdo palë, do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'u njoftohet palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më të gjatë se 40 ditë kalendarike ose në qoftë se një palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë secila prej palëve ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

8.4 Secila palë ka të drejtë që brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike, nga dita që ka marrë njoftim për vendimin e ERE-s, do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.



Neni 9
Ndryshimet

Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja Palët dhe të miratuar nga ERE.

Neni 10
Klauzola përfundimtare

10.1 Palët njohin risinë dhe përkohshmërinë e kësaj kontrate dhe si rrjedhojë njohin faktin se paraqitet nevoja për të pasur një periudhë provë dhe një nivel të mirë fleksibiliteti gjatë vazhdimit të saj.

10.2 Në përputhje me sa më sipër, palët bien dakord që do të: i) ndërmarrin të gjitha veprimet që janë të arsyeshme, në mirëbesim, që janë të nevojshme për të siguruar vijimësinë e shërbimit dhe aplikimit të kësaj kontrate; ii) negociojnë dhe të amendojnë këtë kontratë kur është e nevojshme për t'u përshtatur me të gjitha ndryshimet në aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë; iii) përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe në këtë kontratë të mos e ndërpresin ose të pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi si rezultat i ndonjë vendimi në pritje për ndonjë debat ndërmjet palëve.

Neni 11
Hyrja në fuqi dhe afati i zbatimit të kontratës

11.1 Kjo kontratë nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.

11.2 Kjo marrëveshje ka afat 1-(një) vjeçar dhe i shtrin efektet e saj nga data 1.1.201_ (data e fillimit) deri në datën 31.12.201_.

Mbahet në 3 (tri) kopje origjinale, nga një për secilën palë dhe një për ERE.

Për
KORPORATËN ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE, KESH SHA
ADMINISTRATORI
Agron Hetoja

Për
OPERATORI I SISTEMIT TË
SHQIPTARE TRANSMETIMIT, OST SHA
ADMINISTRATORI

Engj³ll Zeqo

VENDIM
Nr. 2, datë 2.2.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“FATLUM” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “PERROLLAJ”
ME FUQI TË INSTALUAR 0.5 MW**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Perrollaj”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar ne: nenin 9, pikat 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pikat 2 (dokumentacionin juridik, administrator dhe pronësor); nenin 9, pikat 3 (dokumentacionin financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuara në: nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni tekniko- ekonomik); neni 9, pika 4.1.5 (leje nga institucione të tjera), është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “FATLUM” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Përrollaj”, me fuqi të instaluar 0.5 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 3, datë 2.2.2015

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES TË SHOQËRISË “FATLUM”
SHPK NGA HEC “PËRROLLAJ”, ME
FUQI 0.5 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “l”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC “Përrollaj” me fuqi 0.5 MW.

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “FATLUM” sh.p.k., është plotësuar konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” - plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Faqe|1116

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC “Përrollaj” me fuqi 0.5 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 4, datë 2.2.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“ROBERTO OIL” SHA, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 8, 10/3 ; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Roberto OIL” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm



- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit, i paplotësuar.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi nga prokuroria, që drejtuesi i shoqërisë nuk është në proces penal dhe struktura e funksionimit administrativ të shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike:

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e paplotësuar.

Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e paplotësuar.

Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 5, datë 2.2.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË ROBERTO OIL SH.A. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1 germa “ç”; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria Roberto Oil sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Roberto Oil sh.a.” plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit, i paplotësuar

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. Mungon vërtetimi nga prokuroria, që drejtuesi i shoqërisë nuk është në proces penal dhe struktura e funksionimit administrativ të shoqërisë.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9, germa “a”. Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet për furnizimin e klientëve të kualifikuar për pesë vitet e ardhshme



- Neni 9, pika 4/9, germa “b”. Mungon niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar.

- Neni 9, pika 4/9, germa “c”. Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Roberto Oil sh.a.”, për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 6, datë 2.2.2015

**MBI KËRKESËN E OST SHA PËR
RISHIKIMIN DHE PEZULLIMIN E
VENDIMIT NR. 141, DATË 26.12.2014 TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-
s “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMEVE NDIHMËSE PËR VITIN
2015”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16, pika 3, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 141 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktimin e

tarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015”, konstatoi se:

- Mënyra e shpërndarjes së kostove në sistemin elektroenergjetik është diskrecion i ERE-s e cila është e detyruar me ligj të mbulojë të gjitha kostot e nevojshme për segmentet e tregut të rregulluar, për mirëfunksionimin e tij.

- Tarifa e shërbimeve ndihmëse aplikohet për herë të parë dhe konsiderohet në fazë eksperimentale.

- Është lënë detyra që, brenda tremujorit të parë të vitit 2015 të rishikohet midis palëve saktësia e llogaritjes dhe testimi i aplikimit të kësaj tarife.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 141, datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktimin e tarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015” si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në vendimin nr. 141, datë 26.12.2014.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 141 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për përcaktimin e tarifës së shërbimeve ndihmëse për vitin 2015”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 7, datë 2.2.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA
ENERGY TRADE” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 8 dhe 10,



pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 8, datë 2.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE “ SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4 dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14 pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gjerat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.



2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 9, datë 4.2.2015

**MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES
MIDIS KESH SHA DHE OST SHA PËR
SIGURIMIN E SHËRBIMEVE
NDIHMËSE DHE TË BALANCIMIT TË
SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, nenit 26, pika 1; nenin 35, pika 1, germa “b” dhe pika 2, germa “b”, si dhe neni 41, pika 3, germa “ç”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, 5.2 (i) dhe pika 7, germa “P”, paragrafi 4 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM-në nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, kapitullit V të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 4.2.2015, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-së, mbi kontratën “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik” për vitin 2015 ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OST sh.a.;

konstatoi se:

1. Palët e kësaj marrëveshje janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e marrëveshjes “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik” duke pasur parasysh që:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.

- Shoqëria OST sh.a. është licencuar në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009

2. Marrëveshja është e nënshkruar nga të dyja palët.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik”, për vitin 2015, bashkëlidhur këtij vendimi

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2015 deri në datën 31 dhjetor 2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

KONTRATË
PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE
NDIHMËSE DHE TË BALANCIMIT TË
SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK
NDËRMJET
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT SHA
(më poshtë referuar si “OST” sh.a.)
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga
“Viktor Eftimiu” Tiranë
dhe
KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
(më poshtë referuar si KESH sh.a.)
Adresa: Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë
OST sh.a. dhe KESH sh.a. më poshtë
referuar si “palët”
Tiranë, _____2014

Baza ligjore

a) Baza ligjore për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate është ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar);

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”;

c) Kodi i Rrjetit të Transmetimit, i miratuar dhe i ndryshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë vendim nr. 123, datë 24.10.2008;



d) Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 68, datë 23.6.2008 “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”;

e) Vendimi nr. 24, datë 26.3.2009, me të cilin Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vendosur rinovimin e licencës për transmetimin e energjisë elektrike, OST sh.a.;

f) Vendimet nr. 23, datë 25.3.2009, nr. 10, datë 6.2.2014, dhe nr. 34, datë 13.5.2014, me të cilat Enti Rregullator i Energjisë (ERE), ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin, furnizimin publik me shumicë, dhe tregtimin e energjisë elektrike, KESH sh.a.;

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kontratë ose kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këto përkufizime:

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë dhe të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen kësaj kontratë së bashku me anekset dhe çdo dokumentacioni bashkëlidhur. “Data e fillimit” do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të bëhet efektive.

“Muaji” do të thotë periudha kohore, e cila fillon në orën 00:00 të ditës së parë kalendarike të muajit dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit kalendarike të po atij muaji.

“Viti” do të thotë periudha kohore, e cila fillon në orën 00:00 të ditës së parë të vitit kalendarik dhe mbaron në orën 24:00 të ditës së fundit të po atij viti kalendarik

“OST sh.a” është Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, i cili operon bazuar në licencën e dhënë nga ERE.

“KESH sh.a” – Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, i cili operon bazuar në licencën e dhënë nga ERE.

“Palët” do të thotë OST sh.a. dhe KESH sh.a.

“ERE” – Enti Rregullator i Energjisë.

“Sistemi i transmetimit” është një sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, që përdorën për transmetimin e energjisë elektrike.

“Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përberë nga centralet e prodhimit të

energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

“Pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike” do të thotë një person i licencuar ose i autorizuar nga ERE për të marrë pjesë në tregun shqiptar të energjisë elektrike me funksione të specifikuara.

“Shërbime ndihmëse” ku përfshihet dhe energjia balancuese, janë të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemit të transmetimit dhe që bëjnë të mundur: i) ruajtjen e qëndrueshmërisë statike të sistemit elektroenergjetik; ii) respektimin e programit të shkëmbimeve ndërkufitare; iii) mbajtjen e niveleve të tensionit brenda niveleve të lejuara; dhe iv) rivendosjen e sistemit elektroenergjetik kur ka rënie të pjesshme ose të plotë, në rastin e avarive të mëdha.

“Rezerva e rregullimit primar të frekuencës” është ajo rezervë që në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara, aktivizohet automatikisht dhe plotësisht brenda 30 sec, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 min, nëpërmjet kontrollit automatik RASH (Rregullatori Automatik i Shpejtësisë) të çdo agregati që mbahet vazhdimisht në punë.

“Rezerva e rregullimit sekondar frekuence/fuqi aktive” është ajo rezervë që me shfaqjen e devijimit të frekuencës dhe/ose shkëmbimit të energjisë nga vlerat e lejuara dhe të skeduluara, vihet në punë në mënyrë automatike pas rreth 30 sec dhe shfrytëzohet plotësisht brenda një intervali jo më të madh se 15 min.

“Rezerva e rregullimit terciar” është rezervë joautomatike që aktivizohet me kërkesë të Operatorit të Sistemit. Rezerva terciare përbëhet nga pjesa e sinkronizuar (në rrotullim) dhe pjesa e pasinkronizuar që duhet të bëhet eficiente brenda një intervali prej rreth 10 minutash, dhe shërben për mbajtjen në eficientë të rezervës rrotulluese, si dhe përballimin e incidenteve të mundshme në gjenerim.

“Rezerva rrotulluese” kjo rezervë përbëhet nga rezerva e rregullimit primar, rezerva e rregullimit sekondar, dhe pjesa e sinkronizuar e rezervës së rregullimit terciar.

“Njësi balancimi” një njësi gjeneruese e aftë për të bërë oferta dhe propozime për mekanizmin e balancimit.

“Mekanizmi i balancimit” një mekanizëm i operuar nga Operatori i Tregut të OST



nëpërmjet të cilit pranohen oferta dhe propozime me qëllim që të arrihet balancimi fizik i SEE.

“Disbalanca” është diferenca midis fluksit të energjisë të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe (p.sh., nominimi fizik i programit) dhe fluksit aktual të matur të energjisë, për një orë të caktuar.

“Përfaqësues i autorizuar” është person i ngarkuar zyrtarisht nga përfaqësuesi ligjor i kompanive OST sh.a. dhe KESH sh.a. për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate.

“Tarifat e shërbimeve ndihmëse” një listë tarifash të miratuara nga ERE.

“Tarifat e shërbimit të balancimit” tarifat e përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE.

“Faturë paraprake” për efekt të kësaj kontrate me fatura paraprake do të kuptohet dokumenti shkresor, i dërguar nga OST sh.a., i cili përmban përcaktimet e bëra në nenin 11.

“Faturë tatimore” për efekt të kësaj kontrate me faturë do të kuptohet fatura tatimore për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit, i cili përmban përcaktimet e bëra në nenet 11 dhe 13.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për skedulimin, deklarimin dhe garantimin në sasinë dhe cilësinë e kërkuar të shërbimeve ndihmëse dhe shërbimet e balancimit. Mënyrën e llogaritjes dhe faturimin e shërbimeve ndihmëse dhe shërbimeve të balancimit.

Neni 3

Detyrimet e KESH sh.a.

3.1 KESH sh.a. merr përsipër të sigurojë shërbimet ndihmëse dhe shërbimet e balancimit për OST sh.a., në sasinë dhe kohën e kërkuar prej saj dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

3.2 Kjo kontratë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe sigurimin e shërbimit të balancimit ka prioritet mbi të gjitha kontratat e tjera të shitjeve që bëhen nga KESH sh.a.

Neni 4

Shërbimet ndihmëse që sigurojnë kontrollin e frekuencës dhe programin e shkëmbimit

KESH sh.a. merr përsipër të sigurojë shërbimet ndihmëse sipas përcaktimeve të paraqitura në anekset e kësaj kontrate.

Neni 5

Shërbimet ndihmëse që sigurojnë gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive, mbajtjen e niveleve të tensionit

5.1 KESH sh.a. merr përsipër të sigurojë që gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive, do të garantohet nga njësitë gjeneruese, me kërkesën e Qendrës Dispeçer të OST sh.a. në përputhje me kushtet e lidhjes me rrjetin e transmetimit.

5.2 Në bazë të studimeve mbi shpërndarjen e fluksit dhe nivelet e tensionit, Qendra Dispeçer e OST sh.a. udhëzon njësitë gjeneruese të KESH sh.a. të mbajnë nivele tensioni të specifikuar në pikat e lidhjes së tyre me sistemin e transmetimit.

5.3 Kërkesat minimale për njësitë gjeneruese të KESH sh.a. që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse përcaktohen në aneksin 2.

Neni 6

Mundësia për ristartim

6.1 KESH sh.a. merr përsipër të mbajë grupe diesel në të tri centralet e saj, për të mundësuar ristartimet e tyre në mungese të tensionit në pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit.

6.2 KESH sh.a. duhet të garantojë që grupet diesel në secilin prej centraleve, duhet të jenë në kushte të mira dhe në gatishmëri në çdo kohe, në mënyrë që agregatet të startohen pa fuqi të jashtme nga Sistemi i Transmetimit.

Neni 7

Mossigurimi i shërbimeve ndihmëse

7.1 Nëse KESH sh.a. nuk siguron shërbimet ndihmëse të përcaktuara në këtë kontratë, do të jetë përgjegjës për mbulimin e kostove të OST sh.a. për zëvendësimin dhe sigurimin e këtyre shërbimeve, nëpërmjet programeve të kompensimit.

7.2 Kompensimi i devijimeve nga programi i shkëmbimit, i livrimit të energjisë në rrjetin interkonektiv ose i tërheqjes së energjisë nga rrjeti interkonektiv, jashtë programit të



shkëmbimit, bëhet nëpërmjet programeve të kompensimit, që llogariten nga Qendra Koordinatave e Rajonit, me bazë javore, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zone kontrolli (OST), për t'u livruar/tërhequr nga rrjeti interkonektiv, sipas tarifave (blloqe orare) të ENTSO-E.

Neni 8

Detyrimet e OST sh.a. (për shërbimet ndihmëse)

OST sh.a. do të dërgojë në KESH sh.a. skedulin vjetor jo më vonë se 1 (një) dhjetori për vitin pasardhës, skedulin mujor jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të muajit për muajin pasardhës, të cilët do të paraqesin në mënyrë indikative kapacitetin në MW të rezervës së sinkronizuar (automatike dhe joautomatike). Skedulimi javor do të dërgohet jo më vonë se ora 12:00 am e ditës së fundit të punës (e premte) për javën pasardhëse. Ky skedulim do të përcaktojë, për ditën e mesatarizuar të javës së ardhshme, kapacitetin në MW me bazë orare, të kapacitetit rezervë të rregullimit sekondar (automatik) për të dy drejtimet rritje/ulje, dhe të kapacitetit rezervë të rregullimit terciar (joautomatik) për të dy drejtimet rritje/ulje. Gjithashtu, skedulimi do të tregojë afërsisht numrin e orëve kur për agregatat në punë mund të kërkohej të punojnë në regjim mbicksitimi ose nënëksitimi, brenda kurbës së mundësisë të çdo agregati. Normalisht ky skedulim është i vlefshëm për të gjitha ditët e javës në avancë. Në rast se do të ketë ndryshime të regjimit të punës (ngarkesës së parashikuar të vendit), OST-ja mund të emetojë skedulimin e ri, gjithmonë përpara orës 12:00 të ditës korente, për ditën në advance.

Neni 9

Kontrolli, monitorimi dhe testimi

Aktivitetet e kontrollit monitorimit dhe testimit për njësitë gjeneruese, që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse, do të realizohen në përputhje me pikën IV.12 të Kodit të Rrjetit. Në veçanti, monitorimi i kapacitetit rezervë do të bëhet nëpërmjet sistemit SCADA që është disponibël si për operatorin e OST-së ashtu edhe për operatorin e KESH-it për centralet e tij. Vlerësimi i disponibilitetit dhe i aftësisë rregulluese të kapacitetit rezervë në kohë

reale, do të bëhet nëpërmjet treguesit të devijimit nga programi i shkëmbimit (ACE), që normalisht duhet të jetë brenda intervalit ± 10 MW.

Neni 10

Çmimi për sigurimin e shërbimeve ndihmëse

10.1 Çmimi për shërbimet ndihmëse do të jetë çmimi që do të miratohet nga ERE, bazuar në metodologjinë që do të miratojë kjo e fundit për përcaktimin e çmimit për ofrimin e shërbimeve ndihmëse.

10.2 Palët bien dakord që çdo çmim dhe/ose tarife e re që do të përcaktohet nga ERE përgjatë afatit kohor të vlefshmërisë së kësaj kontrate, apo ndryshime të tjera në aktet rregullatore, do të zbatohet nga palët pa pasur nevojën e amendimit të kontratës.

Neni 11

Llogaritja/matja, faturimi i shërbimeve ndihmëse

11.1 Brenda datës 10 të çdo muaji, për muajin paraardhës, OST-ja do të përgatisë dhe dërgojë në KESH një faturë paraprake me informacionin e nevojshëm për sasinë e shërbimeve ndihmëse të vendosura në dispozicion të saj nga ana e KESH-it. Fatura paraprake do të shoqërohet me tabelat përkatëse që japin informacion për çdo central/agregat, me bazë orare, për kapacitetin max të mundshëm të gjenerimit, kapacitetin min të mundshëm të gjenerimit, energjinë e gjeneruar, kapacitetin rezervë në drejtimin rritje të gjenerimit, kapacitetin rezervë në drejtimin ulje të gjenerimit, si dhe kapacitetin e rezervës të kërkuar nga OST-ja në skedulimet javore të muajit.

11.2 Energjia e prodhuar nga çdo agregat do të vlerësohet nga regjistrimet e sistemit të matjes (qendra e menaxhimit të energjisë në OST), me bazë orare. Kapaciteti rezervë në drejtimin rritje do të vlerësohet si diferencë e kapacitetit max të mundshëm me energjinë e prodhuar në orën përkatëse. Kapaciteti rezervë në drejtimin ulje do të vlerësohet si diferencë e energjisë së prodhuar me kapacitetin min të mundshëm në orën përkatëse. Këto të dhëna (vlerësime) do të përdoren për verifikimin e kapacitetit rezervë disponibël në orët kur devijimi nga programi i shkëmbimit (ACE) do të rezultojë më i madh se ± 20 MW. Në rast se për orët e identifikuara me ACE $>\pm 20$ MW, do të rezultojë mosdisponibiliteti i kapacitetit rezervë në drejtimin respektiv rritje (+), ulje (-), në masën



më shumë se $\frac{1}{2}$ e kapacitetit të kërkuar nga OST-ja në orën përkatëse, atëherë këto orë do të reduktohen nga numri total i orëve të muajit përkatës për të cilin bëhet llogaritja e shumës që duhet të faturohet për disponibilitetin e kapacitetit rezerve, sipas drejtimit respektiv në rritje/ulje. Për thjeshtësi në llogaritje dhe paraqitje, kapaciteti rezervë, sipas llojit sekondar/terciar dhe drejtimit në rritje/ulje, do të vlerësohet me një vlerë të vetme, që paraqet mesataren e kapacitetit të kërkuar nga OST-ja për çdo orë të muajit, bazuar në skedulimin javor me bazë orare që i dërgohet KESH-it nga ana e OST-së. Me fiksimin e këtyre parametrave, pra të kapacitetit mesatar dhe numrit të orëve kur është bërë disponibël ky kapacitet, llogaritja e shumës që do të paguhet, bëhet sipas formulës:

Shuma [€] = kapaciteti [MW] x (numri i orëve) x çmimi [€/MWh]

11.3 Me marrjen e faturës paraprake nga OST-ja, brenda 5 ditëve, KESH-i përgatit faturën (tatimore) sipas rregullave të faturimit në fuqi, dhe e dërgon në OST.

Meqenëse të dhënat (SCADA dhe rezultatet e matjes) për kryerjen e llogaritjeve janë të njëjta për të dyja palët, nuk pritet të ketë mosmarrëveshje (diferenca) për saktësinë e llogaritjeve në faturën paraprake. Në rast se një gjë e tillë do të ndodhë, palët fillojnë një proces identifikimi dhe sqarimi të bazuar në tabelat shoqëruese me bazë orare për çdo agregat, deri sa të arrijnë në sinkronizimin e rezultateve.

Neni 12

Shërbimi i balancimit

12.1 OST-ja siguron energjinë balancuese të nevojshme për të mbuluar disbalancat e krijuara nga pjesëmarrësit e tregut, nga KESH sh.a. nëpërmjet kësaj kontrate.

12.2 Shërbimi i disbalancës së energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale. Ai përfshin devijimet nga programet e transaksioneve dypalëshe. Ai mbulon, gjithashtu, flukset e paparashikuara të energjisë në sistem (për shembull nga sistemet jashtë Shqipërisë).

12.3 Një gjenerator është në disbalancë negative kur gjenerimi i tij i matur është më i vogël se

livrimi i tij i kontraktuar.

12.4 Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është në disbalancë negative kur konsumi i tij matur është më i madh se kërkesa e tij e kontraktuar.

12.5 Një gjenerator është në disbalancë pozitive kur gjenerimi i tij i matur është më i madh se livrimi i tij i kontraktuar.

12.6 Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është në disbalancë pozitive kur konsumi i tij i matur është më i vogël se kërkesa e tij e kontraktuar.

12.7 Disbalancat brenda nivelit të përcaktuar në Rregullat e Tregu të Energjisë Elektrike do të kompensohen në natyrë në bazë në javën pas operimit.

Neni 13

Çmimi i energjisë për sigurimin e shërbimit të balancimit

13.1 Çmimi i energjisë së disbalancimit është çmimi me të cilin energjia e balancimit do të paguhet.

13.2 Çmimi për energjinë balancuese do të jetë çmimi i llogaritur sipas Rregullave të Tregut të miratuar nga ERE, ku:

a) Çmimi i energjisë balancuese llogaritet për çdo muaj me çmimin maksimal të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar nga KESH sh.a. plus 10% të këtij çmimi ose në mungesën e tij me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga FPSH-ja prej prodhuesve të vegjël, HEC-eve të rinj koncensionar, të miratuar nga ERE plus 20% të këtij çmimi, për disbalancat negative.

b) Çmimi i energjisë balancuese në rastet e disbalancave pozitive do të jetë çmimi i gjenerimit publik.

13.3 Palët bien dakord që çdo çmim dhe/ose tarife e re që do të përcaktohet nga ERE përgjatë afatit kohor të vlefshmërisë së kësaj kontrate, apo ndryshime të tjera në aktet rregullatore, do të zbatohet nga palët pa pasur nevojën e amendimit të kontratës.

Neni 14

Llogaritja/matja, faturimi i energjisë për shërbimin balancues

14.1 Çdo muaj, OST sh.a. do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancave disbalancave (pozitive dhe negative) mujore.



14.2 Brenda datës 5 të muajit $n+1$, KESH sh.a. i dërgon OST sh.a. çmimin mesatar (të ponderuar) të importeve të energjisë elektrike për muajin n .

14.3 OST sh.a. brenda datës 10 të muajit $n+1$ do t'i dërgojë KESH sh.a. faturën përkatëse. Në llogaritjen e pagesave OST sh.a. do të përdorë kursin mesatar të këmbimit të euro/lekë të muajit n të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 15

Pagesa e shërbimeve ndihmëse dhe energjisë për shërbimin balancues

15.1 OST-ja do të kryejë pagesën në KESH sh.a. kundrejt vlerave të faturave mujore përkatëse për shërbimet ndihmëse. Pagesa do të bëhet brenda ditës së 30 të muajit kalendarik në të cilën është lëshuar secila prej faturave nga KESH sh.a.

15.2 Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse OST sh.a. dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në pagimin e kamatëvonesës në masën e: Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje. Kamatëvonesa paguhet pa qenë i detyruar që KESH-i të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa. Vlera totale e kamatëvonesave të aplikuara për çdo faturë nuk mund të kalojë vlerën e vetë faturës.

Neni 16

Mospërformanca për shkak të forcës madhore

16.1 Përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë kontratë, “forca madhore” për qëllimet e kësaj kontrate do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale që e pengon atë palë të realizojë disa ose të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Ngjarjet e forcës madhore do të përfshijnë pa kufizim:

a) Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si: tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë secilën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të një pale dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe që pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj, si dhe rastet e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 9072 të datës 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar).

16.2 Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas kësaj kontrate dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 13.3 të këtij neni, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhë kohore që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar demet (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim) nuk do t'i kërkohej dhe merret palës lidhur me sasi të palivruara respektivisht të pamarrë si rezultat i forcës madhore.

16.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi kontakton forcën madhore, pala që kërkon përjashtim nga detyrimet e veta, do të njoftojë palën tjetër për ngjarjen e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet ekonomikisht të favorshme dhe të ligjshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimit të forcës madhore, do t'i sigurojë palës tjetër të dhëna të përditësuara, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

Neni 17

Garancitë dhe mbështetja e kredisë

17.1 Shitësi dhe blerësi janë të detyruar të lëshojnë në kuadrin e kësaj kontrate përkatësisht:

Blerësi një garanci financiare dhe shitësi një garanci performance, sipas termave të më poshtëm:



a) Garancia financiare: Për të mbuluar risqet e aftësisë pagueuse të blerësit ndaj shitësit lidhur me sasinë e energjisë elektrike të livruar për të siguruar plotësimin e menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të tjera që rezultojnë nga kjo kontratë, Blerësi do të ketë ngurtësuar, 10 ditë kalendarike përpara muajit përkatës të livrimit, në favor të shitësit, garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon $\frac{1}{2}$ të sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar, e cila do të jetë e vlefshme deri në datën e fundit të muajit pasardhës të muajit të livrimit të energjisë me çmim shitje të përcaktuar sipas kësaj kontrate. Garancia bankare duhet të lëshohet nga një bankë e nivelit të dytë të licencuar në vend.

b) Garancia e performancës: Në rast se shitësi dështon të përmbushë detyrimet e tij për livrimin e energjisë elektrike sipas skedulit të paraqitur nga blerësi, për më shumë se tri ditë radhazi, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi vendosjen e një garancie performance në formën e një garancie financiare në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuar në vend, në vlerën që i korrespondon sasisë mesatare të energjisë elektrike të programuar në një javë (- GWh) me çmimin e blerjes të miratuar nga ERE.

Pas marrjes së njoftimit me shkrim, pala tjetër brenda tri (3) ditëve pune do t'i sigurojë palës kërkuar garancinë e kërkuar të performancës.

17.2 Ndryshimi i dëmshëm material: Një ndryshim i dëmshëm material do të ketë ndodhur nëse ka ndodhur një ose më shumë nga ngjarjet e specifikuar nga vetë palët.

Neni 18

Zgjidhje e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

18.1 Për çdo gjë të pashprehur në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të legjislacionit që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.

18.2 Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me të gjitha aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

18.3 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, përfaqësuesit e autorizuar për çdo palë, do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrë-

veshjen, zgjidhja do t'iu njoftohet palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më të gjatë se 40 ditë kalendarike, ose në qoftë se një palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë secila praj palëve ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

18.4 Secila palë ka të drejtë që brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike, nga dita që ka marrë njoftim për vendimin e ERE-s, do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 19

Ndryshimet

Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja palët dhe të miratuar nga ERE.

Neni 20

Klauzola përfundimtare

20.1 Palët njohin risinë dhe përkohshmërinë e kësaj kontrate dhe si rrjedhojë njohin faktin se paraqitet nevoja për të pasur një periudhë prove dhe një nivel të mirë fleksibiliteti gjatë vazhdimit të saj.

20.2 Në përputhje me sa më sipër, palët bien dakord që do të: i) ndërmarrin të gjitha veprimet që janë të arsyeshme, në mirëbesim, që janë të nevojshme për të siguruar vijimësinë e shërbimit dhe aplikimit të kësaj kontrate; ii) negociojnë dhe të amendojnë këtë kontratë kur është e nevojshme për t'u përshtatur me të gjitha ndryshimet në aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë; iii) përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe në këtë kontratë të ruajnë siç parashtrohet në këtë kontratë, të mos e ndërpresin ose të pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi si rezultat i ndonjë vendimi në pritje për ndonjë debat ndërmjet palëve.

Neni 21

Hyrja në fuqi dhe afati i zbatimit të kontratës

21.1 Kjo kontratë nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.



21.2 Kjo marrëveshje ka afat 1-(një) vjeçar dhe i shtrin efektet e saj nga data 1.1.2015 (data e fillimit) deri në datën 31.12.2015.

Mbahet në 3(tre) kopje origjinale, nga një për secilën palë dhe një për ERE.

Për
KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE,
KESH SHA
ADMINISTRATORI
Agron Hetoja

Për
OPERATORI I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT, OST SHA
ADMINISTRATORI
Engjëll Zeqo

ANEKSI 1

Palët bien dakord që rezerva primare, sekondare, dhe terciare do të sigurohen nga KESH sh.a. duke përdorur burimet e mëposhtme. KESH sh.a. do të bëjë përpjekjet e tij me të mira për të siguruar që gjatë kohëzgjatjes së kontratës do të sigurojë shërbimet ndihmese sipas tipit, sasisë dhe cilësisë sipas kërkesës së OST sh.a.

1. Rezerva e rregullimit primar vendoset në të gjitha agregatet e lidhur direkt me rrjetin e transmetimit, në mënyrë sa më uniforme dhe proporcionale që të jetë e mundur. (Kodi i Rrjetit IV.7.4.4). Njësitë gjeneruese duhet të jenë të pasura me Rregullator Automatik të Shpejtësisë (RASH). Saktësia e matjes së frekuencës për rregullimin primar duhet të jetë më e mirë ose e barabartë me 10 mHz. Intervali i mos ndjeshmërisë së rregullatorit të njërive gjeneruese nuk duhet të kalojë ± 10 mHz. Aktivizimi i Rregullimit Primar në njësitë gjeneruese fillon para se devijimi i frekuencës të kalojë ± 20 mHz (që është shuma e saktësisë së matjes së frekuencës dhe intervali i mos ndjeshmërisë së rregullatorit. Sipas planifikimit vjetor që bëhet nga ENTSO-E, kontributi i zonës sonë të kontrollit në rregullimin primar për vitin 2014 është 7 MW, nga mbi 3000 MW që është rezerva totale e këtij rregullimi për rrjetin sinkron të ENTSO-E, dhe konstantja e vendosur në rregullatore (karakteristika fuqi – frekuencë e rrjetit) 60 MW/Hz, nga 26 905 MË/Hz që është konstantja totale e rrjetit sinkron. Në rastin kur

sistemi elektroenergetik punon i izoluar nga sistemet fqinje, rezerva minimale e rregullimit primar vendoset jo më e vogël se 5% e ngarkesës totale të sistemit.

2. Rezerva e rregullimit sekondar përdoret (në mënyrë automatike) në rast të devijimit të frekuencës nga vlera nominale dhe/ose të balancës së shkëmbimit nga vlera e programuar. Kjo rezervë vendoset në agregatet/centralin rregullues të destinuar për këtë qëllim. Sipas Manualit Operacional të ENTSO-E (Policy 1), për llogaritjen e kësaj rezerve, në mënyrë orientuese, përdoret formula e mëposhtme:

$$R = \sqrt{aL_{\max} + b^2} - b, \text{ ku } a = 10, b = 150, \text{ dhe}$$

L është ngarkesa e konsumit.

Rregullimi Sekondar shfrytëzon në mënyrë të centralizuar dhe të vazhdueshme Rregullimin Automatik të Gjenerimit, duke modifikuar pikën e punës të fuqisë aktive të njërive gjeneruese me ngarkese të rregullueshme të cilat marrin pjesë në rregullimin sekondar, për një periudhë kohe që fillon pas disa sec e deri në 15 min pas incidentit. Saktësia e matjes së frekuencës për rregullimin sekondar duhet të jetë ndërmjet 1.0 mHz dhe 1.5 mHz.

3. Rezerva e rregullimit terciar është rezervë joautomatike që aktivizohet me kërkesë të Operatorit të Sistemit, dhe përdoret për të mbajtur në efektivitet rezervën e rregullimit sekondar kur kjo ezaurohet, dhe amortizimin në një farë mase të incidenteve të mundshme në gjenerim. Bazuar në faktin se njësitë gjeneruese të lidhura në rrjetin e transmetimit, jashtë juridiksionit të KESH-it, janë me kapacitet të instaluar të rendit 10-15 MW, në këtë kontratë (për efekt pagese) do të merret në konsideratë vetëm rezerva terciare e sinkronizuar. Në rast se një nga agregatet e KESH-it del jashtë pune për shkak avarie, ai duhet të zëvendësohet nga agregati rezervë brenda të njëjtut central, ose nga agregatet në centralet e tjera të KESH-it, brenda një intervali prej rreth 10 minutash, me qëllim rivendosjen sa më të shpejtë të rezervës sekondare dhe terciare të sinkronizuar, të kërkuar nga OST-ja në skedulimin javor përkatës.

Në tabelën e mëposhtme jepen centralet dhe kapaciteti i instaluar i njërive gjeneruese, të cilat do të sigurojnë shërbimet ndihmese për sistemin elektroenergetik.



Centrali	Kapaciteti i instaluar ne MW
Fierza	4 x 125
Komani	4 x 150
V.Dejes	5 x 50

Alokimi i kapacitetit të rezervës për të tria llojet e rregullimit të gjenerimit, në varësi të ngarkesës së konsumit në MW, duke përdorur formulat e lartpërmendura, dhe duke plotësuar kriterin e rezervës sinkrone në nivelin 5 – 6 % të ngarkesës së konsumit, jepet në tabelën e mëposhtme:

Ngarkesa	500	600	700	800	900	1000	1100	1200	1300	1400	1500	1600
R.primare	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
R.sekondare	16	19	22	25	27	30	33	36	38	41	44	46
Rezerva automatike	21	24	27	30	32	35	38	41	43	46	49	51
R.terciare	13	15	18	20	23	25	28	30	33	35	38	40
Rezerva e sinkronizuar	33	39	44	50	55	60	66	71	76	81	86	91
Kapaciteti llogarites	28	34	39	45	50	55	61	66	71	76	81	86

ANEKSI 2

Çdo njësi gjeneruese që merr pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse minimumi duhet të ketë aftësitë e mëposhtme:

i) të gjenerojë dhe të operojë me parametra normal për frekuenca të sistemit të transmetimit në diapazonin 49.5 Hz – 50.5 Hz;

ii) të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 47.5 Hz – 49.5 Hz dhe 50.5 Hz – 52.5 Hz për një kohë prej 60 minutash;

iii) të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 47.0 Hz – 47.5 Hz për një kohë prej 20 sekonda. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është nën 47.5 Hz;

iv) të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit për frekuenca në sistemin e transmetimit në diapazonet 52.5 Hz – 53 Hz për një kohë prej 5 sekondash. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është mbi 52.5 Hz;

v) të mbetet e sinkronizuar me sistemin e transmetimit gjatë ndryshimit të frekuencës në sistemin e transmetimit në vlera me të mëdha dhe të barabarta me 0.5 Hz për sekondë;

vi) të vazhdojë operimin në minimumin e specifikuar të gjenerimit brenda vlerave 49.8 Hz – 51.0 Hz;

vii) të mbetet e sinkronizuar gjatë ndryshimit të nivelit të tensionit në sistemin e transmetimit në vlera me të mëdha dhe të barabarta me 10%;

viii) të vazhdojë operimin në përputhje me kurbën e aftësisë reaktive siç kërkohet nga sistemi i transmetimit për mbajtjen e niveleve të tensionit;

ix) të vazhdojë të mbetet i sinkronizuar gjatë prishjes së balancës gjenerim – ngarkese sipas standardeve IEC 60034-1;

x) vlera e rrymës së lidhjes së shkurtër duhet të jetë sipas standardeve IEC 60034-1;

xi) gjenerimi minimal: jo më i madh se 35% e kapacitetit nominal;

xii) aftësia për rritjen e gjenerimit: jo më i vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minute, kur njësia është në kushte normale operimi;

xiii) aftësia për uljen e gjenerimit: jo më i vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minutë, kur njësia është në kushte normale operimi;

xiv) njësitë gjeneruese duhet të vazhdojnë të operojnë dhe kur profilet e tensionit në sistemin e transmetimit janë në nivelet e paraqitura në tabelën e mëposhtme:



Niveli i tensionit	Lidhur në:	Në kapacitet maksimal $\cos\phi$	Në 35% të kapacitetit maksimal $\cos\phi$
99kV – 123kV	110 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
90kV – 100kV		0.85	0.7 – 0.4
140kV – 163kV	150 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
125kV - 140kV		0.85	0.7 – 0.4
198kV – 242kV	220 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
190kV – 200kV		0.85	0.7 – 0.4
360kV – 420kV	400 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
350kV- 360kV		0.85	0.7 – 0.4

ANEKSI 3

Formati i skedulimit vjetor, mujor, dhe ai javor që do të përdoret si bazë për llogaritjen e kapacitetit rezerve, sipas llojit të rregullimit dhe drejtimit, jepet në tabelën e mëposhtme.

Vlerat e vendosura në tabelë janë vetëm për demonstrim, pasi ato paraqesin ngarkesën (konsumin) me bazë orare, për ditën e mesatarizuar të vitit 2013, dhe vlerat e llogaritura të rezervës sekondare sipas formulës përkatëse, si

dhe rezervën terciare, ku shuma e të dy llojeve të rezervave (automatike dhe jo) është rreth 5-6% të ngarkesës së konsumit të parashikuar për orën përkatëse. Kapaciteti llogaritet vlerësohet për të dy drejtimet e rregullimit, në rritje dhe në ulje të gjenerimit. Në rast se do të kërkohen vlera (kapacitete) të ndryshme për drejtime të ndryshme, atëherë në tabelë do të paraqiten me rreshta të veçantë sipas drejtimit (katër rreshta), por mënyra e llogaritjes mbetet e njëjtë.

Dita e mesatarizuar	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Mesat
Ngarkesa (konsumi)	635	567	534	523	531	593	741	927	1001	1011	999	991	985	987	979	974	998	1048	1087	1127	1137	1061	923	756	880
R.sekondare (+/-)	20	18	17	17	17	19	23	28	30	31	30	30	30	30	30	30	30	32	33	34	34	32	28	23	27
R.terciare (+/-)	16	14	13	13	13	15	19	23	25	25	25	25	25	25	24	24	25	26	27	28	28	27	23	19	22
Kapaciteti llogarites	72	64	60	60	60	68	84	102	110	112	110	110	110	110	108	108	110	116	120	124	124	118	102	84	98

Me supozimin se tabela e mësipërme paraqet kapacitetin e mesatarizuar të rezervës së kërkuar nga OST-ja për një muaj të caktuar, atëherë mënyra e llogaritjes se shumës që duhet të faturohet për çdo shërbim të kapacitetit rezerve, jepet në tabelën e mëposhtme, ku është përdorur formula:

Shuma [€] = kapaciteti [MW] x (numri i orëve) x çmimi [€/MWh]

Emërtimi i kapacitetit rezervë, të kërkuar nga OST-ja	Kapaciteti në MW	Vlerësimi i orëve të muajit, kur kapaciteti rezervë është bërë disponibël	Çmimi në €/MWh	Shuma mujore në €
R. sekondare +	27	720	X1	Y1
R. sekondare -	27	720	X2	Y2
R. terciare +	22	720	X3	Y3
R. terciare -	22	720	X4	Y4
Shuma totale	98			Y



Për këtë rast, vlerësimi i orëve është bërë i plotë, për muajin me 30 ditë, pra me supozimin se për çdo orë të muajit në fjalë, devijimi nga programi i shkëmbimit ACE ka rezultuar më i vogël se ± 20 MW, që do të thotë se për çdo orë të këtij muaji ka qenë disponibël rezerva e nevojshme për të bërë rregullimin. Në rast se nga realizimi i grafikut dispeçer me bazë orare të çdo ditë, do të rezultojnë orë me ACE $>\pm 20$ MW, atëherë (pas verifikimit për çdo rast) këto orë do të reduktohen nga shuma totale e orëve të muajit përkatës.

Çmimi i vendosur në tabelë për çdo lloj rregullimi dhe drejtimi, është referues. Referenca është marrë nga të dhënat (tenderi) i zhvilluar nga të katër TSO-te e Gjermanisë për vitin 2012, për blerjen e këtij lloj shërbimi (rezerva sekondare, terciare). Gjithsesi, palët do të zbatojnë nenin 10.4 të kësaj kontrate.

VENDIM

Nr. 10, datë 4.2.2015

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT” TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE OSHEE SHA PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 4.13, germa “a”, pikat 3 dhe 7, germa “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.2.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.,

konstatoi se:

1. Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike duke ditur që:

- OST sh.a. është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009,

- OSHEE sh.a. është licencuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014.

2. Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

3. Modeli i tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e “Marrëveshjes së shërbimit të transmetimit” të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për vitin 2015, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e saj nga data 1 janar 2015 deri në datën 31 dhjetor 2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

MARRËVESHJE E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT

**NDËRMJET OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA
(“OST” SHA) DHE
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
(“OSHEE” SHA)**

Tiranë, ____ dhjetor 2014

Kjo Marrëveshje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike lidhet sot më datë ____/____/2014 midis:

Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, rruga “Viktor



Eftimiu”, Tiranë, Shqipëri, me NIPT nr. K42101801N, përfaqësuar nga administratori z. Engjëll Zeqo,

nga njëra anë, dhe

Shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., (më poshtë referuar si OSHEE sh.a.) person juridik i së drejtës shqiptare regjistruar me vendimin nr. 38587, datës 19.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën “Andon Zako Çajupi”, pallati Conad, kati i 3-të, Tiranë, Shqipëri, pajisur me NIPT K72410014H, përfaqësuar nga administratori z. Adrian Cela,

Baza ligjore:

a) ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar);

b) vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e Modelit të Tregut të energjisë elektrike”;

c) vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 68, datë 23.6.2008 “Rregullat e tregut të energjisë elektrike” (i ndryshuar);

d) vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 123, datë 24.10.2008 “Për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit” (i ndryshuar);

e) vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 24, datë 26.3.2009 “Për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike Shoqërisë OST sh.a.”;

f) vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 96, datë 27.10.2014 “Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”;

g) vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 97, datë 27.10.2014 “Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike”;

h) vendimi nr. Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2015.

Neni 1

Përkufizime

Në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijon:

a) “Marrëveshje” do të thotë kjo Marrëveshje

për Shërbimin e Transmetimit, së bashku me skedulet dhe dokumentacionin tjetër bashkë-lidhur.

b) “Data e fillimit” do të thotë dita nga e cila marrëveshja fillon të shtrihe efektet e saj.

c) “Palët” do të thotë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.

d) “OST sh.a.” është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispencerimit të sistemit elektroenergetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike dhe personi juridik i licencuar për transmetimin e energjisë elektrike

e) “OSHEE sh.a.” është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes. Dhe personi juridik i licencuar për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

f) “FPP” furnizues publik me pakicë është personi i licencuar për të furnizuar me energji elektrike klientët tariforë.

g) “Pikat e marrjes” janë daljet 110 kV; daljet 220 kV të transformatorit ngritës të HEC-ve dhe TEC-ve dhe linjat e interkonjeksionit në marrje.

h) “Pikat e dhënies” janë hyrjet 110 kV të transformatorit ules 110/TM kV të shpërndarjes; daljet 35 kV, 20 kV dhe 10 kV të transformatorëve 220/110/35-20-10 kV të OST sh.a., daljet e përdoruesve të lidhur direkt në Rrjetin e Transmetimit dhe linjat e interkonjeksionit në dhënie.

i) “Pikat e matjes” janë pikat e lidhjes se aparateve matës nëpërmjet të cilave bëhet e mundur matja e Energjisë Elektrike që kalon në atë element. Ato do të jenë në pikat e marrjes dhe të dhënies.

j) “Disbalanca” është diferenca midis sasisë të energjisë të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe dhe fluksit aktual të matur të energjisë, për një ore të caktuar.

k) “Sistem matës” është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtësit e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes të të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllorë të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në pikën e matjes.

l) “Program” do të thotë sasia orare (për çdo orë të ditës në avancë) të energjisë elektrike që



kërkon OSHEE në pikat e dhënies, programimi i së cilës bëhet nga OSHEE-ja.

m) “Transmetimi” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

n) “Sistem i Transmetimit” është sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, të përdorura për transmetimin e energjisë elektrike.

o) “Përfaqësues i autorizuar” është personi i ngarkuar zyrtarisht nga administratori i për ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje dhe nënshkrimin e deklaratës së matjes.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë marrëveshje që nuk është përkufizuar këtu më lart ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (të ndryshuara) miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008 dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 24.10.2008 “Për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit” (i ndryshuar).

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

2.1 Objekti i marrëveshjes (“Marrëveshja”) është sigurimi i Shërbimit të Transmetimit për OSHEE sh.a. duke transmetuar nga pikat e marrjes deri në pikat e dhënies, sasinë e energjisë elektrike që OSHEE sh.a. kërkon të transmetojë, siç është përcaktuar në këtë marrëveshje. Transmetimi i energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të fillojë në datën e fillimit të parashikuar në nenin 15.

2.2 Sasia e energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST-ja, do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 123, datë 24.10.2008 të ERE-s, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008 të (ERE) dhe Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM-në datë 19.3.2008.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e OST sh.a.

3.1 OST sh.a. do të sigurojë shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për OSHEE sh.a., në Faqe| 1132

sasitë dhe për periudhën kohore të specifikuar në këtë Marrëveshje, me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose rastet e një ndërprerjeje të paplanifikuar dhe të planifikuar (sipas përcaktimeve të bëra në nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje).

3.2 OST sh.a. do të sigurojë këtë shërbim në përputhje me Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (të ndryshuara) miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008 dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 24.10.2008 “Për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit” (i ndryshuar).

3.3 OST sh.a. ka të drejtë të faturojë dhe të arkëtojë vlerën e shërbimit të kryer në përputhje me këtë marrëveshje.

3.4 OST-ja ka të drejtë të ndërpresë shërbimin në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e OSHEE SHA

4.1 OSHEE-ja do të informojë OST në lidhje me sasinë e energjisë elektrike dhe programin e caktuar (programi) mbi bazë të orëve,, që do të transmetohet për llogari të OSHEE sh.a. nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, jo më vonë se ora 16:00 çdo të mërkurë për javën e ardhshme të transmetimit. Programi i deklaruar nga OSHEE-ja përbëhet nga programi i importit (sipas kontratave përkatëse të OSHEE) dhe nga programi i furnizimit për plotësimin e nevojave të konsumatorëve tarifor. OST-ja do të konfirmojë me shkrim, fax ose e-mail, programin jo më vonë se ora 12:00 çdo të premte për javën e ardhshme. Ky parashikim ngarkese do të përditësohet në bazë të ditës në avancë para mbylljes së portës. OST-ja ka të drejtë të reduktojë programin e transmetimit (të furnizimit) për një periudhë të caktuar kohe, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse për këtë reduktim, sipas neneve 9 dhe 10 të kësaj marrëveshjeje.

4.2 OSHEE-ja do të informojë OST-ja për sasinë e energjisë elektrike dhe programin e caktuar (skedulimin) me bazë orare, me numra të plotë në MW, të energjisë që do të transmetohet



për llogari të OSHEE nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avancë, jo më vonë se ora 14:00 të çdo ditë (në ditën D, për ditën D+1) për ditët e fundjavës ose të festave, programi do të jepet në avancë, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit.

Programi i deklaruar nga OSHEE-ja, paraqet një tabelë (*worksheet*), ku për çdo ore të ditës në avangje, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të tërhiqet (konsumohet) në të gjitha pikat e dhënies në kufirin transmetim –shpërndarje. Këto vlera të skedulimit për çdo orë, paraqesin shumën e programit të importit me programin e furnizimit të konsumatorëve tarifore dhe që jepen në kolona të veçanta në të njëjtën tabelë (skedulim ditor).

Programi i importit me bazë orare, deklarohet gjithashtu në OST, në një tabelë të veçantë, ku specifikohet kufiri nga ku realizohet importi dhe kompania furnizuese, sipas kontratave të OSHEE-së, shpërndarë për muajin ose periudhën përkatëse.

OSHEE sh.a. ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, me kushtin që version i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar me parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, jo më vonë se dy orë para bërjes efektive të ndryshimit.

4.3 OSHEE-ja ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që version i ri i skedulimit duhet të deklarohet në OST, jo më vonë se dy orë para bërjes efektive të ndryshimit.

OSHEE sh.a. do të informojë OST për sasinë e energjisë elektrike, nominimin me bazë orare, me numra të plote në MW, të energjisë që do të transmetohet nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avangje, jo më vonë se ora 14:00 të çdo ditë (në ditën D, për ditën D+1) për ditët e fundjavës ose të festave, programi do të jepet në avangje, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit. Programi (nominimi) i deklaruar nga OSHEE sh.a. paraqet një tabelë, ku për çdo orë të ditës në avangje, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të furnizohet dhe tërhiqet (konsumohet) në të gjitha pikat e matjes.

OSHEE sh.a. ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që version i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar me parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, jo më vonë se dy orë para bërjes efektive të ndryshimit.

4.4 OSHEE sh.a. do të përfitojë shërbimin e siguruar nga OST sh.a. në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë marrëveshje dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (të ndryshuara) miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008 dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 24.10.2008 “Për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit” (i ndryshuar).

4.5 OSHEE sh.a. merr përsipër t’i paguajë OST sh.a. për sa është parashikuar në objektin e kësaj marrëveshje, çmimin sipas tarifave të miratuara nga ERE dhe të përgjigjet për disbalancat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Planifikimi i kërkesës

Planifikimi i kërkesës për energji elektrike do të bëhet sipas detyrimeve që kanë palët, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 123, datë 24.10.2008 të ERE-s, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin nr. 68, datë 23. 6.2008 të (ERE) dhe Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008.

Neni 6

Sasia e transmetuar, çmimi, faturimi dhe pagesa

6.1 OST-ja do të masë sasinë e energjisë se transmetuar për ditën paraardhëse, me bazë orare, për llogari të OSHEE sh.a, në pikat e dhënies dhe do të informojë OSHEE-në në formë elektronike (“Deklarimi/(et) i/(e) matjes nga OST”) mbi sasinë e sipërpërmendur, jo më vonë se ora 12:00 çdo të ditë të javës, si dhe ditën e hënë për 3 ditët e kaluara të fundjavës (e premte, e shtunë, e diel).

6.2 Kur në sistemin e matjes, nuk janë transmetuar të dhënat përkatëse, për shkak të



defektit ose rënies së matësit për kërkesën, OST-ja për qëllimet e likuidimit do të vlerësojë sasinë e transmetuar të energjisë elektrike, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të tjerë matës gjatë periudhës përkatëse.

6.3 Brenda 3 (tri) ditëve të para të punës, të çdo muaji kalendarik, OST-ja do të informojë OSHEE-në me shkrim (me shkëmbimin midis tyre të dokumenteve origjinale në rrugë zyrtare), mbi sasinë totale të energjisë elektrike të transmetuar, gjatë muajit paraardhës dhe të matur në pikat e dhënies.

6.4 OSHEE-ja do të japë konfirmimin e saj ose do të bëjë ankese në lidhje me saktësinë e të dhënave me shkrim ose fax ose e-mail, brenda 2 (dy) ditëve të para të punës nga dita e marrjes së njoftimit nga OST. Pas këtij afati konfirmimi do të quhet i mirëqenë.

6.5 Në qoftë se OSHEE, nuk është dakord me këtë informacion, atëherë OSHEE-ja duhet t'i paraqesë OST-se, brenda dy ditë pune nga momenti i marrjes së këtij informacioni në rrugë zyrtare, një shpjegim me shkrim në lidhje me arsyet e kontestimit. OST-ja nga ana e saj brenda dy ditë pune të ardhshme duhet të njoftojë me shkrim OSHEE-në për qëndrimin e saj në lidhje me këtë kontestim.

Raiffeisen Bank:

ALL 0100025276

IBAN: AL32202110130000000100025276

EUR 8000356494

IBAN: AL45202110130000008000356494

Intesa Sanpaolo Bank:

ALL 20124135303

IBAN: AL70208110080000020124135303

EUR 20124135301

IBAN: AL27208110080000020124135301

Union Bank:

ALL111107595030113

IBAN:AL96214111060111107595030113

EUR111207595030124

IBAN:AL90214111060111107595030124

Credins Bank:

ALL142150

IBAN:AL20212110160000000000142150

EUR142152

IBAN:AL63212110160000000000142152

BKT:

ALL402230823

IBAN:AL4620511021230823 CLCUALLA

EUR402230823

IBAN:AL1320511021230823 CLCUCFEURA

6.11 Në qoftë se OSHEE-ja do të kontestojë një informacion si ai i përcaktuar në pikën 6.3 të kësaj marrëveshje, atëherë OSHEE-ja duhet t'i paraqesë OST-së, brenda dy ditë pune nga momenti i marrjes së këtij informacioni në rrugë

6.6 Nëse OST-ja e konsideron të bazuar ankesën, do të nxjerrë një raport të ri mujor të cilën ia përcjell OSHEE-së. Në rast se OST-ja e konsideron pretendimin si të pabazuar, njofton OSHEE-në dhe nxjerr faturën tatimore mujore të shërbimit të transmetimit (këtu e më poshtë “fatura”). Fatura do t'i dërgohet OSHEE në origjinal. Fatura, do të paraqesë sasinë e energjisë elektrike të transmetuar nga OST-në në muajin paraardhës, të matur në pikat e dhënies.

6.7 Fatura që OSHEE-ja do t'i paguajë OST-së sipas kësaj Marrëveshje është si më poshtë:

Faturimi për shërbimin e transmetimit.

6.8 OST-ja do të dorëzojë faturën për energjinë elektrike të transmetuar në muajin paraardhës çdo datë 10 të muajit kalendarik pasardhës. Në rast se data 10 e muajit pasardhës, përkon me një ditë pushimi, dorëzimi bëhet ditën e punës që pason ditën/ditët e pushimit.

6.9 OSHEE sh.a. do të realizojë pagesën brenda 10 ditëve duke filluar nga data 20 e muajit kalendarik deri me datë 30 të po këtij muaji kalendarik, dhe nëse dita e fundit nuk është ditë pune, ditën tjetër të punës.

6.10 Pagesa e faturave do të bëhet në nr. e llogarisë bankare të OST-së:

zyrtare, një shpjegim me shkrim në lidhje me arsyet e kontestimit. OST-ja nga ana e saj brenda dy ditëve pune të ardhshme duhet të njoftojë me shkrim OSHEE sh.a. për qëndrimin e saj në lidhje me këtë kontestim.



6.12 Në qoftë se OSHEE-ja kundërshton në mënyrë të drejtë shumën e një fature të lëshuar nga OST-ja, shuma e padebatueshme do të paguhet në çdo rast në datën e duhur. Kundërshtime në mënyrë të drejtë do të konsiderohen vetëm ato që bëhen për gabimet që rezultojnë nga veprimet e OST-së.

- Në rastin e mbipagesës, interesi do të përlogaritet nga data në të cilën është realizuar pagesa deri në datën që efektivisht realizohet kthimi i vlerës tepër të paguar, sipas legjislacionit në fuqi.

- Nëse rezultati i faturës nuk është i drejtë ose OST-ja nuk ka vepruar në mënyrë të arsyeshme në menaxhimin e paqartësisë së faturës ose në llogaritjen e pagesës së debatueshme, atëherë OST-ja do të paguajë një normë interesi sipas legjislacionit në fuqi.

6.13 Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse OSHEE sh.a. dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, konsiston në pagimin e kamatëvonesë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

6.14 Në rast se OSHEE-ja dështon në pagesat e faturave të energjisë elektrike deri në dy muaj pas datës se parashikuar në pikën 6.9, OST-ja ka të drejtë të mbajë vlerën e faturës së bashku me normën e interesit të grumbulluar, nga garancia financiare e depozituar nga OSHEE-ja e depozituar nga OSHEE-ja për regjistrim në tregun e energjisë elektrike konform rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike që do të miratohen nga ERE. Në çdo rast, OST-ja do të veprojë në përputhje me procedurat e parashikuara në rregullat “Për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”, e miratuara nga ERE.

6.15 Palët bien dakord që çdo çmim dhe/ose tarifë që do të përcaktohet nga ERE përgjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të aplikohet automatikisht dhe eventualisht do të zëvendësojë ndonjë çmim të ndryshëm dhe/ose tarifë të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Neni 7

Disbalancat

7.1 Trajtimi dhe llogaritja e disbalancave do të kryhen sipas Rregullave të Tregut të Energjisë

Elektrike të miratuara nga ERE. Çdo ndryshim i rregullave të tregut në lidhje me çështjen e balancimit do të hyjë automatikisht në fuqi.

Neni 8

Konfidencialiteti

8.1 Palët bien dakord që, për sa është e mundur, me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga ligji (duke përfshirë edhe rregullat e nxjerra nga çdo autoritet rregullator me juridiksion mbi palën), marrëveshjet e paraqitura këtu, se bashku me çdo dokument ose të dhënë të transmetuar një palë ndaj të tjerave, janë dhe duhet të mbeten konfidenciale. Gjithashtu, asnjë palë nuk duhet t’iu komunikojë të tretëve (përveç auditëve ose këshilltarëve të saj financiare ose ligjore, bankës korrespondente ose çdo organi qeveritar me juridiksion mbi palën), asnjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshje ose detaj të çdo marrëveshje të paraqitur këtu, pa aprovimin paraprak të shkruar të palës tjetër. Në qoftë se informacioni duhet të jepet, pala së cilës i kërkohet informacioni duhet të njoftojë palën tjetër dhe të marrë masa të arsyeshme për të kërkuar mbrojtjen e informacionit të kërkuar nga të tjera kërkesa.

8.2 Parashikimet e bëra në paragrafin 8.1 ngelen në fuqi për 5 vjet nga data e përfundimit të kontratës.

Neni 9

Forca madhore

9.1 Raste të forcës madhore

Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë Marrëveshje, asnjë palë nuk do të konsiderohet në shkelje të kushteve të kësaj Marrëveshje në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshje është i shkaktuar nga një rast force madhore. Për efekt të kësaj marrëveshje një rast force madhore është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë palët të përmbushë detyrimet të saj sipas marrëveshjes, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palët dhe nuk ndodhin për faj të palës përkatëse nuk ajo është në gjendje t’i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë: përpjekjet dhe kujdesin e saj, si edhe



rastet e parashikuara nga neni 3, pika 40 dhe neni 47 i ligjit nr. 9072 të datës 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar).

9.2 Reagimi ndaj një rasti të force madhore

Çdo palë do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme që të mënjanojë, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, arsyen e çdo vonesë ose ndërprerje në zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të limituar demet e palës tjetër. Në qoftë se një palë merr njohuri për një rast force madhore që do të ndikojë apo mund të ndikojë mbi disa ose të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshje, detyrohet të njoftojë menjëherë me shkrim Palën tjetër për situatën. Për të fituar kohë, ky komunikim mund të bëhet edhe në rrugë telefonike, por duhet të ndiqet edhe nga një komunikim i menjëhershëm me shkrim. Në të njëjtën mënyrë duhet vepruar edhe në rastet kur ndodh pushimi/mbarimi i rastit të forcës madhore.

9.3 Vazhdimi i kryerjes së detyrimeve

Në rast force madhore, palët do të ndërmarrë përpjekjet e saj me të mira, në mënyrë që të:

- i) Vazhdojë të kryejë detyrimet sipas kësaj Marrëveshje për sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, duke dhënë informacione të sakta ditore mbi sasinë e energjisë elektrike që është në gjendje të transmetojë, në vartësi të rrethanave.
- ii) Minimizojë pasojat në lidhje me rastin e forcës madhore.

Neni 10

Ndërprerje të paplanifikuara

10.1 Nëse do të ndodhë një prej ngjarjeve të mëposhtme, OST-ja ka të drejtën të ndërpresë transmetimin e energjisë elektrike, për sa kohë që vazhdon ngjarja e ndërprerjes. Ngjarje të tilla janë:

i) Prishje e pajisjeve si edhe linjave të transmetimit të OST-së dhe të linjave të transmetimit të interkoneksionit, të cilat nuk mund të parashikoheshin ose riparoheshin.

ii) Kur OST-ja është e detyruar të realizojë kufizime në transmetimin e energjisë elektrike me qëllimin e sigurisë në punë të sistemit elektroenergjetik, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 128, datë 24.10.2008 të ERE-s dhe Rregullave

të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008 të ERE-s.

10.2 OST-ja do të bëjë përpjekjet me të mira të mundshme në mënyrë që të përfundojë sa më shpejt kryerjen e punimeve dhe minimizojë shqetësim/problemet për OSHEE-në.

OST-ja me anë të një akti teknik do të njoftojë zyrtarisht OSHEE-në në lidhje me ngjarjen e ndërprerjes.

Neni 11

Ndërprerje të planifikuara

11.1 Procesi i ndërprerjeve të planifikuara do të bëhet konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 128, datë 24.10.2008 të ERE-s.

11.2 Në mënyrë që të lejohet, OSHEE-ja të marrë masat e përshtatshme, OST-ja, në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes palëve (OST-OSHEE), do të informojë me shkrim OSHEE jo më vonë se 20 ditë para fillimit të punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve dhe objektin ku do të kryhen këto punime. Pas këtij njoftimi, OST-ja lejohet të fillojë punimet e mirëmbajtjes pa pasur nevojën e një aprovimi paraprak nga ana e OSHEE-së. Në rast se OSHEE-ja ka shkaqe të arsyeshme për të kërkuar mosndërprerjen e energjisë elektrike, njofton OST-në brenda tri ditë pune nga marrja e njoftimit për remontin, njoftim i cili merret në konsideratë në çdo rast nga OST-ja.

11.3 OST-ja detyrohet të përfundojë kryerjen e punimeve brenda afatit të njoftuar.

Neni 12.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe llojet e zbatueshme

12.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha aktet nënligjore në fuqi.

12.2 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje, mosmarrëveshja do t'i njoftohet përfaqësuesve të autorizuar për trajtimin e mosmarrëveshjeve të çdo Pale, të cilët do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin atë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se Përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'u njoftohet palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për



ato. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, ose në qoftë se një palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë çështja do të zgjidhet nga ERE sipas ligjit për sektorin e energjisë, Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit.

12.3 Kur mosmarrëveshjet e palëve i referohen interpretimit të Kodit të Rrjetit palët do të veprojnë në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vendimi i ERE-s është i detyrueshëm për zbatim nga palët.

12.4 Secila prej palëve ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në rast se nuk është dakord me zgjidhjen e dhënë nga ERE për mosmarrëveshjen sipas pikës 12.2.

Neni 13.

Autorizimet/kushtet paraprake

13.1 Palët pohojnë dhe garantojnë që kanë marrë ose janë duke marrë të gjitha autorizimet e nevojshme dhe licencat e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

13.2 Çka parashikohet në këtë Marrëveshje, me përjashtim të këtij neni (i cili do të hyjë në fuqi menjëherë pas firmosje nga të dyja palët), do të hyjë në fuqi pasi të jenë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) firmosja nga të dyja palët, e marrëveshjes.
- b) miratimi i kësaj marrëveshje nga ERE.

Neni 14

Njoftimet, përfaqësuesit e autorizuar etj.

14.1 Menjëherë pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje, çdo palë do të përcaktojë me shkrim një përfaqësues të autorizuar ("përfaqësuesi i autorizuar") që do të jetë i autorizuar të nënshkruajë deklaratën e matjes.

14.2 Njoftimet, faturat (që parashikohen në nenin 6 më lart) ose dokumente të tjera në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen me shkresërisht në selitë zyrtare ose me faks në numrat e përcaktuar më poshtë dhe do të presupozohen të marrë kur aparati që ka dërguar faksin do të ketë konfirmuar transmetimin. Çdo palë mund të ndryshojë numrin e saj të faksit duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Në rast se

njëra palë ka ndryshuar numrin e faksit, pa njoftuar me parë palën tjetër, çdo njoftim i dërguar nga pala te numri i mëparshëm, do të konsiderohet i marrë prej palës që ka bërë ndryshimin dhe nuk ka njoftuar.

14.3 Palët bien dakord që t'i njoftojnë strukturat e tyre përkatëse për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe t'i udhëzojnë ato për detyrimet që rrjedhin prej saj dhe marrjen e masave për zbatimin e saj.

14.4 Për çdo ndryshim në përcaktimet e bëra në këtë nen, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën brenda 24 orësh.

Personat e autorizuar për të dy palët do të jenë:

Për OST:

Z. _____

Pozicioni:

OST sh.a.

Bulevardi "Bajram Curri",
Rruga "Viktor Eftimiu",
Tiranë

tel: + 355 4 _____

fax: + 355 4 _____

e-mail: _____

Për OSHEE:

Z. _____

Pozicioni:

OSHEE sh.a.

Rruga "Andon Zako
Çajupi", Pall Conad,
Tiranë

tel: + 355 4 _____

fax: + 355 4 _____

e-mail: _____

Neni 15

Afati i zbatimit të kontratës

Kjo Marrëveshje i shtrin efektet e saj nga data 1.1.2015-31.12.2015.

Neni 16

Rastet e amendimit të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja palët dhe të miratuar nga ERE.



Neni 17

Të ndryshme

17.1 Kjo Marrëveshje është hartuara në 5 kopje origjinale secila me vlerë të njëjtë.

17.2 Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

18.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje, marrëveshja ekzistuese e shërbimit të transmetimit midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. shfuqizohet.

18.2 Palët marrin përsipër dhe premtojnë që:

i) të ndërmarrin veprime të cilat janë të arsyeshme, me ndershmëri, qëndrueshmëri dhe është e rëndësishme të mbajnë vazhdimësinë e shërbimit dhe këtë marrëveshje në ekzistencë;

ii) të ndërmjetësojnë dhe të ndryshojnë këtë marrëveshje nëse do të jetë e nevojshme si rrjedhojë e ndryshimeve në ligj ose akte nënligjore;

iii) të moszgjidhin këtë marrëveshje ose pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi sipas kësaj marrëveshjeje për arsye të ndonjë mosmarrëveshjeje të mbetur pezull.

Tiranë, ____12. 2014

VENDIM

Nr. 11, datë 4.2.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR FURNIZIM ME ENERGJI
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME
SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSHEE
SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME
PAKICË) PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, dhe nenit 26, pika 1, të ligjit 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 germa “A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 datë 23.6.2008,

të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 4.2.2015, pasi u njoh me propozimin e KESH sh.a. me nr. 7627 Prot., datë 29.10.2014 si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s, mbi Marrëveshjen “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSHEE sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për vitin 2015,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, duke ditur që:

- “KESH” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 6.2.2013.

- “OSHEE” sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014.

2. Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

3. Modeli i tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

- Miratimin e marrëveshjes “Për furnizimin me energji elektrike” ndërmjet KESH sh.a./furnizuesit publik me shumicë dhe OSHEE sh.a./ furnizuesit publik me pakicë”, për vitin 2015, bashkëlidhur këtij vendimi.

- Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2015 deri më datë 31 dhjetor 2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**KONTRATË**

**PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE
NDËRMJET KESH SHA/ FURNIZUESIT
PUBLIK ME SHUMICË
DHE OSHEE SHA/ FURNIZUESIT
PUBLIK ME PAKICË
PËR VITIN 2015**

E lidhur sot më datë _____.____.2014, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12728, datë 6.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga z. Agron Hetoja, Administrator i Shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet “shitësi”,

dhe

Shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a.” (më poshtë referuar si OSHEE sh.a.) person juridik i së drejtës shqiptare regjistruar me vendimin nr. 38587, datës 19.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën “Andon Zako Çajupi”, pallati Conad, kati i 3, Tiranë, Shqipëri, pajisur me NIPT K72410014H, përfaqësuar nga administratori z. Adrian Cela, që më poshtë quhet “blerësi”,

Baza ligjore: ligji nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimi nr. 338, datë 19.3.2008, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimi nr. 97, datë 27.10.2014 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënie licence furnizimit publik me pakicë”, vendimi nr. 10, datë 6.2.2010, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për rinovimin e licencës së furnizimit publik me shumicë”,

a) Në kushtet e krijuara nga Modeli i Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, prej nga rrjedh përgjegjësia e furnizuesit publik me shumicë për shitjen të furnizuesi publik me pakicë të energjisë së prodhuar nga KESH GEN-i dhe prodhues dhe/ose tregtare të tjerë për plotësimin e nevojave të klientëve tarifore;

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike për furnizimin e klientëve tarifore si më poshtë vijon:

Neni 1**Subjekti i kontratës**

Kjo kontratë (që përfshin shtojcat e saj) drejton gjithë transaksionet ku do të hyjnë palët për blerjen, shitjen, livrimin dhe pranimin e energjisë elektrike.

Neni 2**Përkufizimet dhe ndërtimi**

1. Përkufizimet: Termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në shtojcën 1.

2. Interpretimi: Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për konvenciençë dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.

3. Referencat në kohë: Referencat në kohë do të jenë sipas kohës qendrore evropiane (CET).

4. Përputhja me Rregullat e Tregut: Kjo kontratë, detyrimet dhe të drejtat e blerësit dhe shitësit, do të jenë subjekt i parashikimeve të Rregullave të Tregut, të aprovuara dhe të modifikuara kohë pas kohe, nga ERE. Në rast se ndonjë parashikim në këtë kontratë është në konflikt me ndonjë parashikim të Rregullave të Tregut, atëherë do të paraprijnë këto të fundit.

Neni 3**Detyrimet e shitësit**

1. Shitësi do të sigurojë gjithë energjinë elektrike në përputhje me sasinë e energjisë elektrike të programuar, në kohën dhe në sasinë siç do t’ia tregojë blerësi shitësit sipas përcaktimeve të Modelit dhe Rregullave të Tregut. Kuptohet se sasia e energjisë elektrike e programuar për të cilën blerësi është i autorizuar nga shitësi do të jetë vlerësimi më i mirë i blerësit i ditës në avancë e ngarkesës së klientëve tariforë të blerësit përfshirë një vlerësim të ngarkesës për çdo orë.

2. Shitësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e gjithë kapacitetit të kërkuar në ditën në avancë, shërbimeve ndihmëse, dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara nga OST-ja që lidhen me kohën e dispecerimit të programit të ditës në avancë.



Neni 4

Detyrimet e blerësit

1. Blerësi do të sigurojë vlerësimet e vitit në avancë, muajit në avancë, javës në avancë dhe ditës në avancë të kërkesave të tij për energji elektrike në një program që do të vendoset mes blerësit dhe shitësit.

2. Blerësi do t'i sigurojë shitësit gjithë të dhënat që lidhen me formën e ngarkesës së klientit të disponueshme për blerësin.

3. Blerësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjithë kapacitetit të programuar, shërbimet ndihmëse dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara dhe të ofruara nga OST-ja që nga pika e livrimit, një pjesë e të cilave përcaktohen në vijim në këtë marrëveshje, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

Neni 5

Detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike

1. Livrimi dhe pranimi: Shitësi do të programojë, shesë dhe livrojë, ose do të bëjë të mundur të livrohet, dhe blerësi do të programojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë të mundur të pranohet sasinë e kontratës sipas programit të deklaruar për ditën në avangë; dhe blerësi do t'i paguajë shitësit çmimin përkatës të kontratës.

2. Përkufizimi i programit: "Program" sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës, dhe me OST, kur aplikohet, sasinë e kontratës, kapacitetin e kontratës, pikën e livrimit, programin e livrimit, periudhën totale të furnizimit, dhe çdo kusht tjetër përkatës të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të OST-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

Neni 6

Livrimi, matja, transmetimi dhe risku

1. Rryma/frekuenca/tensionet: Energjia elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në pikën përkatëse të livrimit sipas standardeve të OST-së dhe OSHEE-së, kur aplikohet si dhe në përputhje me rregullat dhe kodet në fuqi.

2. Programet e deklaruara: Sasia e energjisë elektrike që do të parashikohet nga blerësi t'i livrohet mbi baza vjetore mujore, javore dhe ditore në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike. Nominimi fizik për ditën e nesërme duhet paraqitur në orën 13:00 në përputhje me pikën VI, 3.4 të Rregullave të Tregut.

3. Transferimi i të drejtave të titullit: Livrimi do të realizohet duke bërë të disponueshme sasinë e kontratës me kapacitetin e kontratës në pikën e livrimit. Livrimi dhe marrja në dorëzim e sasisë së kontratës, dhe transferimi nga shitësi te blerësi i të gjitha të drejtave të lira dhe të qarta nga çdo pretendim i kundërt për to, do të zhvillohet në pikën e livrimit.

4. Matja e livrimeve të energjisë elektrike dhe marrjet në dorëzim: Çdo palë është përgjegjëse për të siguruar që livrimet dhe marrjet në dorëzim të energjisë elektrike të maten ose verifikohen me mjetë që janë të evidentuara në mënyrë të arsyeshme në përputhje me procedurat e OST-së dhe OSHEE-ja, kur është e aplikueshme, që drejtojnë në pikën përkatëse të livrimit.

5. Dokumentacioni i programit të ditës në avangë dhe marrjeve në dorëzim: Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, pala do t'i sigurojë palës tjetër dokumentacionin që posedon ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe marrjeve në dorëzim të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të kontratës individuale dhe livrimeve dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike;

6. Rimbursimi i kostove të jashtme: Në rast se njëra palë, me kërkesën e palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj sipas kushteve të kontratës, këto shpenzime do të rimbursohen me kërkesën e palës që ka dështuar në performim.

7. Risqet e shitësit dhe blerësit: Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së kontratës deri në pikën e livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të



vendosur ose shoqëruese të pranimi dhe transmetimit të sasisë së kontratës në dhe nga pika e livrimit.

8. Pikat e livrimit: Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në hyrje të sistemit të transmetimit të OST-së ose në sistemin e shpërndarjes të OSHEE-së për HEC-et e vogla private ose koncensionar që kanë kontratë shitblerje me KESH sh.a./FPSH, sipas rastit, në pikat që mund të caktohen nga shitësi, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

Neni 7

Mosperformanca për shkak të forcës madhore

1. Përkufizimi i forcës madhore: Përveç se kur specifikohet ndryshe, “forcë madhore” për qëllimet e kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës që pretendon forcën madhore (“pala pretenduese”) që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që pala pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon palën pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi; ose

b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimi ose injorimi prej saj të detyrimeve të palës pretenduese lidhur me programimin sipas kontratës.

2. Çlirimi nga detyrimet e livrimit dhe pranimi: Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë kontratave dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 7.3 (njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e palës pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim) nuk do t'i merret palës pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.

3. Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore: Pala pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për forcën madhore, do të njoftojë palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimi të forcës madhore, do t'i sigurojë palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

4. Efektet e forcës madhore mbi palën tjetër: Në rast dhe në atë shkallë që shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të forcës madhore, blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimi dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimi për shkak të forcës madhore, shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

Neni 8

Zhdëmtimet

1. Paaftësia për livrim: Në atë shkallë që pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike (“pala livruese”) nuk arrin të livrojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e kontratës sipas kushteve të kontratës dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e palës tjetër, pala livruese do t'i paguajë palës tjetër (“pala pranuese”) si kompensim për dëmtimet, një shumë të barabartë me kostot e shpenzimeve shtese, të arsyeshme, të argumentuara dhe të verifikueshme që pëson pala pranuese furnizuesi publik me pakicë (FPP) si pasojë e paaftësisë për livrim energji elektrike të konsumatorët tariforë.

2. Kompensimi i detyrimeve për livrim të tepërt mbi planifikimin.

Çdo sasi e energjisë elektrike e livruar për furnizim të konsumatorëve tariforë më tepër nga ajo e planifikuar nga ana e palës pranuese, do të trajtohet sipas Rregullave të Tregut miratuar nga ERE.

3. Kompensimi i devijimeve të humbjeve.

Në rast se OSHEE sh.a./furnizuesi publik me



pakicë, ka importuar fizikisht një sasi energjie elektrike të ndryshme nga sasia e energjisë elektrike e barabartë me nivelin faktik të humbjeve të sistemit të shpërndarjes sipas rregullave të përcaktuara në Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, atëherë palët do të kompensojnë njëra-tjetrën, si më poshtë:

1. Në rastin e importit të një sasie më të madhe, KESH sh.a. do t'i kompensojë fizikisht me sasi energjie OSHEE sh.a., këtë diferencë pozitive deri në fund të muajit pasardhës të muajit në të cilin ka ndodhur devijimi. Në rastin e importit të një sasie më të vogël sesa humbjet reale në rrjetin e shpërndarjes, OSHEE sh.a. do të kompensojë këtë sasi të energjisë elektrike të siguruar nga KESH sh.a., deri në fund të muajit pasardhës të muajit në të cilin është kryer livrimi, me vlerën monetare që i afrohet kostove reale të shkaktuara shoqërisë KESH sh.a. për sigurimin e kësaj sasie të energjisë elektrike, duke respektuar renditjen e mënyrave të listuara më poshtë:

- Kompensimi do të realizohet me çmimin mesatar të ponderuar të importit të energjisë elektrike të shoqërisë KESH sh.a. (jo për qëllim optimizimi) për muajin përkatës;

- Në mungesë të importit të energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a., kompensimi do të bëhet me vlerën monetare që i korrespondon çmimit mesatar të ponderuar të eksportit (jo për qëllim optimizimi) në muajit të shoqërisë KESH sh.a. për muajin përkatës;

- Së fundmi, në mungesë të referencave të mësipërme, kompensimi do të realizohet në vlerën monetare që i korrespondon çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE-ja për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për muajin përkatës;

4. Paaftësia për pranim: Në atë shkallë që pala pranuese nuk arrin tërësisht ose pjesërisht të pranojë sasinë e kontratës në përputhje me kontratën, dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e palës tjetër, do të trajtohet sipas Rregullave të Tregut miratuar nga ERE.

5. Shumat e pagueshme: Shumat e pagueshme sipas nenit 8 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 13 (faturimi dhe pagesa).

Neni 9

Pezullimi i livrimit

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të disponueshme për një palë (“pala që përmbush detyrimet”), nëse njëra palë (“pala që nuk përmbush detyrimet”) nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas kontratës, ose nëse ajo ose garanti i kredisë nuk arrin ta sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e sigurisë së performancës të kërkuar sipas kontratës ose çdo dokumenti mbështetës të kredisë, pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se tri (3) ditë pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit) sipas gjithë kontratave individuale deri kur pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e zbatueshme) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve, apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe të drejtat e përfundimit

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga ERE. Ajo mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 11

Çmimi

1. Çmimet për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë ato të përcaktuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin përkatës.

Neni 12

Kufizimi i përgjegjësisë financiare

1. Përjashtimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikave 12.2 dhe 12.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 8 (zhdëmtimet), një palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agjentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm (“dëmet”),



(përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një kontrate individuale) që pëson pala tjetër sipas marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agentëve të saj, përdorur nga kjo palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas kontratës.

2. Dëmi pasues dhe kufizimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikës 12.3, përgjegjësia ligjore e një pale sipas kontratës ose lidhur me të:

a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe

b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumën e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një palë sipas çdo kontratë individuale përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 8 (zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim).

3. Mospagesa e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore: Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të palës, për:

a) mospagesën e qëllimshme;

b) mashtrimin; ose

c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një pale.

4. Detyra për lehtësimin e humbjeve: Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë dëmet dhe premtion që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo dëmi që mund të pësojë sipas kontratës ose lidhur me të.

Neni 13

Faturimi dhe pagesa

1. Faturimi dhe pagesa: Shitësi do t'i lëshojë blerësit, brenda datë 15 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike për muajin e mëparshëm, dy fatura që paraqesin: i) sasinë totale të energjisë elektrike, që u programua ose livrua (sipas dispozitave ligjore në fuqi) prej blerësit, sipas kontratës gjatë muajit të

mëparshëm kalendarik për furnizimin e konsumatorëve tariforë; dhe ii) kompensimin për devijimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, sipas nenit 8, pika 3, të kësaj kontrate.

Shitësi mund të faturojë në vlerën që i korrespondon sasisë së programuar ose livruar (sipas dispozitave ligjore në fuqi) edhe tarifën, pagesat, rimbursimet, dëmet, interesat, dhe pagesa të tjera ose kredi mes palëve dhe, nëse është e zbatueshme, çdo shumë neto të detyrueshme për pagesë. Pagesa do të bëhet brenda 10 ditëve, duke filluar nga data 20 deri në datën 30 të muajit pasardhës të muajit të livrimit të energjisë elektrike. Kur dhe nëse të dhënat bëhen të disponueshme dhe konfirmojnë që sasinë aktuale të energjisë elektrike të programuara dhe të marra, ndryshojnë nga ato të caktuara në programet e deklaruara ditore, diferencat do të trajtohen në përputhje me aktet ligjore të miratuara nga ERE.

2. Interesi i mospagesës: Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga data e detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përjashtuar datën e pagesës me përqindje interesi. Për këtë qëllim

3. “Përqindja e interesit” është norma e interesit që do të aplikohet për çdo ditë vonesë të pagesës dhe që do të jetë në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi.

4. Shumat e diskutueshme: Nëse një palë, me mirëbesim, vë në diskutim saktësinë e një fature, në datën e pagesës ose para saj do të japë një shpjegim me shkrim të bazës së diskutimit dhe do të paguajë shumën e plotë të faturuar jo më vonë se data e pagesës. Nëse çdo shumë e paguar me diskutim përcaktohet përfundimisht se nuk duhej paguar, kjo mbipagesë, me zgjedhjen e palës detyruese, do t'i kreditohet ose do t'i kthehet palës tjetër brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij përcaktimi, së bashku me interesin e mbledhur me përqindjen e interesit nga data e pagimit të shumës, përfshirë edhe këtë datë, por duke përjashtuar datën 12 të kthimit ose kreditimit.

Neni 14

TVSH-ja dhe taksat

4.1 TVSH-ja: Të gjitha shumën e referuara në këtë kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar (“TVSH”). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të



tillë, blerësi do t'i paguajë shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një palë do të kërkohet për t'u paguar vetëm kur pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohen për qëllimet e kontratës.

4.2 Detyrimet e taksave të shitësit dhe blerësit: Shitësi do të paguajë ose shkaktojë pagesën e gjithë taksave për sasinë e kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të shkaktojë pagesën e gjithë taksave në sasinë e kontratës ose lidhur me të ose të kontratës individuale që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit (përveç taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e sasisë së kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e shitësit). Në rast se shitësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e blerësit, blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë shitësin për këtë taksë. Në rast se blerësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e shitësit, blerësi mund ta zbresë shumën e kësaj takse nga shumat e detyrueshme shitësit sipas kontratës dhe shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë blerësin lidhur me këto taksa të pazbritura. Nëse ndonjë taksë e re bëhet e zbatueshme ose një taksë ekzistuese rritet lidhur me kontratën dhe blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një palë të tretë, blerësi do të jetë përgjegjës për këtë taksë të re ose të rritur.

4.3 Taksa e mbajtur: Pagesat lirë dhe qartë. Gjithë pagesat sipas një kontratë individuale do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një palë i kërkohet të mbajë ose të zbresë taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo palë ("pala paguese") do të njoftojë menjëherë palën tjetër ("pala marrëse") për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, pala paguese do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) palës marrëse.

4.4 Minimizimi i taksave: Të dyja palët do të

përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

Neni 15

Garancitë dhe mbështetja e kredisë

Shitësi dhe blerësi janë të detyruar të lëshojnë në kuadrin e kësaj kontratë përkatësisht:

Blerësi një garanci financiare dhe shitësi një garanci performance, sipas termave të më poshtëm:

1. Garancia financiare: Për të mbuluar risqet e aftësisë paguese të blerësit ndaj shitësit lidhur me sasinë e energjisë elektrike të livruar për të siguruar plotësimin e menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të tjera që rezultojnë nga kjo kontratë, blerësi do të ketë ngurtësuar, 10 ditë kalendrike përpara muajit përkatës të livrimit, në favor të shitësit, garancinë bankare në vlerën monetare që i korrespondon $\frac{1}{2}$ të sasisë mesatare mujore të energjisë elektrike të planifikuar, e cila do të jetë e vlefshme deri në datën e fundit të muajit pasardhës të muajit të livrimit të energjisë me çmim shitje të përcaktuar sipas kësaj kontrate. Garancia bankare duhet të lëshohet nga një bankë e nivelit të dytë të licencuar në vend.

2. Garancia performancës: Në rast se shitësi dështon të përmbushë detyrimet e tij për livrimin e energjisë elektrike sipas skedulit të paraqitur nga blerësi, për më shumë se tri ditë radhazi, atëherë blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi vendosjen e një garancie performance në formën e një garancie financiare në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuar në vend, në vlerën që i korrespondon sasisë mesatare të energjisë elektrike të programuar në një javë (- GWh) me çmimin e blerjes të miratuar nga ERE.

Pas marrjes së njoftimit me shkrim, pala tjetër brenda tri (3) ditëve pune do t'i sigurojë palës kërkuese garancinë e kërkuar të performancës.

3. Ndryshimi i dëmshëm material: Një ndryshim i dëmshëm material do të ketë ndodhur nëse ka ndodhur një ose më shumë nga ngjarjet e specifikuar nga vetë palët.



Neni 16

Sigurimi i pasqyrave financiare dhe vlera neto e preکشme

1. Sigurimi i pasqyrave financiare: Përveç kur specifikohet ndryshe, nëse kërkohet nga njëra palë. Pala tjetër do t'i dorëzojë asaj:

a) brenda 180 ditëve pas mbarimit të çdo viti fiskal, një kopje të raportit vjetor që përmban pasqyra financiare të audituara dhe të konsoliduara për këtë vit fiskal, për periudhën kur detyrimi i palës tjetër mbështetet nga garantuesi i kredisë ose nëse është palë e një marrëveshje kontrolli dhe transferimi të fitimit, nga garantuesi i kredisë ose pala kontrolluese, sipas rastit, dhe

b) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas përfundimit të secilit nga tre tremujorët e tij fiskalë të çdo viti fiskal, një kopje të raportit tremujor që përmban pasqyra financiare të paaudituar të konsoliduar.

2. Rënia e vlerës neto të preکشme: Sapo të bëhet e ndërgjegjshme për këtë rënie, çdo palë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për ndodhinë e rënies të vlerës neto të preکشme ose vlerës neto të preکشme të garantuesit të kredisë ose palës kontrolluese, në një nivel nën shumën e specifikuar nga palët.

3. Parimet financiare: Në çdo rast deklaratat financiare që referohen në pikën 17 do të përgatiten sipas parimeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Transferimi

1. Ndalimi: Asnjëra palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kontratës, një palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme, dhe me miratimin e ERE-s.

2. Transferimi të filialet: Çdo palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër, një filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër dhe, me kusht që çdo dokument mbështetës kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të palës transferuese të jetë

rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e filiait në përfitim të palës tjetër.

Neni 18

Përfaqësimet dhe garancitë

Nëse specifikohet si e zbatueshme për palët, ajo palë përfaqëson dhe garanton në këtë mënyrë palën tjetër pas hyrjes në këtë kontratë për sa vijon:

a) se është një njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;

b) nënshkrimi dhe hyrja në kontratë, në çdo dokument mbështetës kredie ku është palë dhe në kryerjen e transaksioneve të shqyrtuara këtu, nuk do të shkelin asnjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese;

c) ka pushtetin dhe është e autorizuar të ekzekutojë, shpërndajë dhe kryejë detyrimet sipas kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë dhe ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, livrimin, kryerjen dhe hyrjen në kontratë dhe ekzekutimin, livrimin dhe kryerjen e kontratës dhe se çdo dokument mbështetës kredie nuk shkel dhe nuk bie në konflikt me asnjë afat ose kusht tjetër të ndonjë kontrate ku është palë ose ndonjë dokument konstitucional, rregull, ligj ose rregullore në fuqi;

d) ka gjithë autorizimet qeveritare dhe rregullatore, miratimet dhe pëlqimet e nevojshme për të kryer detyrimet sipas kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë;

(e) ka negociuar, ka hyrë dhe ka ekzekutuar kontratën dhe çdo dokument mbështetës kredie ku është palë si kryesore (dhe jo si agent ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe);

e) hyn rregullisht në marrëveshje për tregtimin e energjisë elektrike siç planifikohet nga kontrata, dhe e bën këtë mbi baza profesionale sipas linjës së vet kryesore të biznesit, dhe mund të karakterizohet në mënyrë të arsyeshme si palë profesioniste tregu;

f) vepron për llogari të vet (dhe jo si këshilltar, agent, agent ndërmjetës ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të hyrë në këtë kontratë dhe nëse kjo kontratë është e



përshtatshme ose si duhet për të, bazuar në gjykimin e vet, nuk mbështetet mbi këshillën ose rekomandimet e palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është e aftë për të vlerësuar meritat dhe kupton dhe pranon afatet, kushtet dhe risqet e kontratës;

g) pala tjetër nuk vepron si kujdestar apo këshilltar i saj;

h) nuk mbështetet në asnjë përfaqësim të bërë nga pala tjetër përveç atyre të thëna shprehimisht në kontratë ose në dokumentin mbështetës të kredisë ku është palë;

i) lidhur me një palë që është njësi qeveritare ose sistem energjetik publik, kjo njësi qeveritare ose sistem energjetik publik përfaqëson dhe i garanton palës tjetër si më poshtë:

j) gjithë aktet e nevojshme për ekzekutimin e vlefshëm, shpërndarjen dhe kryerjen e kontratës, përfshirë pa kufizim, ofertat konkurruese, njoftimin publik, zgjedhjen, referendumin, përvetësimin paraprak ose procedura të tjera të kërkuara që janë ndërmarrë ose kryer ose do të ndërmerren dhe kryhen;

k) hyrja në kontratë dhe zbatimi i saj nga një njësi qeveritare ose sistem energjetik publik bëhet për një qëllim të duhur publik brenda kuptimit të dokumenteve përkatëse konstitucionale ose qeveritare dhe legjislacioni në fuqi; dhe

l) afati i kontratës nuk zgjatet përtej ndonjë kufizimi të zbatueshëm të vendosur nga ndonjë dokument tjetër përkatës konstitucional ose qeveritar dhe nga legjislacioni në fuqi; dhe

m) lidhur me një palë, se nuk ka falimentuar, dhe nuk ka procedime ligjore ose administrative pezull ose të kërcënueshme ku të jetë palë dhe që në dijeni të saj do të ndikojnë materialisht në mënyrë të dëmshme aftësinë e saj për kryerjen e çdo detyrimi sipas kësaj kontrate ose ndonjë dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë, të tilla që ta bëjnë të falimentonte.

Neni 19

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH-së.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me kontratën do t'i referohet

fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë, gjithashtu, zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 20

Të ndryshme

1. Regjistrimi i bisedave telefonike: Çdo palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura lidhur me kontratën dhe t'i përdorë si provë. Çdo palë heq dorë nga çdo njoftim tjetër mbi këtë regjistrim dhe pranon se ka marrë gjithë pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të vet për këto regjistrime.

2. Njoftimet dhe komunikimet: Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga palët, gjithë njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një palë tjetër duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrijnë brenda 24 orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:

a) nëse shpërndahen dorazi ditën e punës, ose ditën e parë të punës pas datës së livrimit nëse shpërndahen jo në ditën e punës;

b) nëse dërgohen me postë të klasit të parë, ditën e 2-të të punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në ditën e 5-të të punës pas datës së postimit;

c) nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17:00 (me orën e marrësit) në ditën e punës ose në orën 09:00 (me orën e marrësit) në ditën e parë të punës pas transmetimit.

3. Amendimet: Çdo amendim ose shtesë në këtë kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

4. Pavlefshmëria e pjesshme: Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në



ndonjë mënyrë. Palët ndërmarrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit nga ERE.

5. Të drejtat e palës së tretë: Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë kontratën dhe palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.



Korporata
Elektroenergjetike
Shqiptare

Agron Hetoja ADMINISTRATORI

SHTOJCA 1 E KONTRATËS

Termat e përcaktuar

Termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “Pala pranuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 8.1 (paafhtësia për livrim) të kësaj kontrate;

- “Filial” lidhur me një palë do të thotë një njësi e kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo palë, çdo Njësi që kontrollon direkt ose indirekt atë palë ose çdo njësi direkt ose indirekt nën kontrollin e përbashkët të një pale;

- “Kontratë” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (subjekti i kontratës);

- “Çmimi referues alternativ i mallit” ka kuptimin, nëse ekziston, të specifikuar në çdo kontratë individuale që përmban një çmim të paqëndrueshëm;

- “Dita e punës” do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila palë ka zyrën e saj të regjistruar;

- “Blerës” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Disbalanca” është diferenca midis fluksit të energjisë elektrike të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe (nominimi fizik i programit për ditën në avance) dhe fluksit aktual të matur të

Neni 21

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo kontratë, dhe secili nga kushtet këtujë, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrinë efektet për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2015.

2. Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin e ERE.

Neni 22

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë



Ardian Çela ADMINISTRATORI

energjisë, për një ore të caktuar;

- “Data e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm;

- “Metoda e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm;

- “Koha qendrore evropiane” ose “CET” do të thotë koha qendrore evropiane dhe do të përfshijë kohën dimërore qendrore evropiane dhe kohën verore qendrore evropiane sipas zbatimit;

- “Konfirmimi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 3.2 (konfirmimet);

- “Kapaciteti i kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes palëve, i shprehur në MW;

- “Çmimi i kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, çmimi i vendosur mes palëve;

- “Sasia e kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, sasia e vendosur mes palëve, shprehur në MWh;

- “Kontroll” do të thotë pronësia e më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të fuqisë votuese të një pale ose njësie;

- “Vlerësimi i kredisë” lidhur me një njësi do të thotë sa më poshtë: i) vlerësimi afatgjatë i pasiguar, i pavarur i borxhit publik (i



pambështetur nga vlerësimi i kredisë së palës së tretë); ii) vlerësimi i kredisë të nxjerrësit të borxhit; ose iii) vlerësimi i kredisë së korporatës që i është dhënë asaj njësie, në secilin rast “i” deri “iii” nga grupi i vlerësimit standard & dhe të varfër (divizion i McGraw-Hill Inc.) ose Moody’s Investor Services Inc.;

- “Dokumentet mbështetës të kredisë” ka kuptimin e specifikuar, që mund të përfshijë, pa kufizim, një garantues, garanci bankare, letër ndërgjegjësimi, letër kredie ose çdo marrëveshje për mbështetje kredie;

“Garantuesi i kredisë” ka kuptimin e specifikuar lidhur me një palë të specifikuar;

“Shtojca ndërkufitare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 21(k) (përfaqësimet dhe garancitë);

“Dëmet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 12.2 (përfshirja e përgjegjësiave financiare)

“Pala që nuk përmbush detyrimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9.1 (pezullimi i livrimit);

“Pala livruese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 8.1 (paaftësia livruese);

“Pika e livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes palëve;

“Programi i livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes palëve;

“Data e pagesës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13.2 (pagesa);

“EBIT” do të thotë fitimet para interesit dhe taksave që, lidhur me vitin përkatës fiskal, do të jenë të ardhurat neto të njësisë përkatëse para zbritjes së taksave të fitimit (ose çdo takse tjetër mbi të ardhurat ose fitimet në C juridiksionin përkatës të njësisë përkatëse); plus shumën e gjithë interesave dhe çdo shumë në natyrën e interesit që u ngarkohet shpenzimeve që lidhen me detyrimin financiar për paratë e marra borxh (shuma që përfshijnë borxhet e pagueshme filialeve, si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Kosto reale” ka kuptimin e të gjitha shpenzimeve që identifikohen nga kompania për sigurimin e energjisë elektrike nga burimet përkatëse përfshirë edhe gjithë kostot shtesë të paparashikuara (*overdraft*), si dhe çdo vlerësim mbi impaktin e transaksionit në treguesit e e

eficencës së përdorimit të rezervave ujore;

“Data e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj kontrate;

“Njësia” do të thotë një individ, qeveri ose shtet ose divizion, agjenci qeveritare ose shtetërore, korporatë, partneritet ose ndonjë njësi tjetër siç mund ta kërkojë konteksti;

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, ose çdo organizatë pasuese me autoritet të krahasueshëm mbi tarifën, afatet dhe kushtet e energjisë elektrike;

“Forca madhore” ka kuptimin e specifikuar në pikën 7.1 (përcaktimi i forcës madhore);

“Fondet nga operimi” do të thotë shuma në *cash* e gjeneruar ose e përdorur nga njësia përkatëse për aktivitetet e saj operuese;

“Fitimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(b) (shuma e marrëveshjes financiare);

“Mbajtës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimi dhe pranimi sipas një opsioni);

“Përqindja e interesit” ka kuptimin e specifikuar në pikën 13.5 (interesi i mospagesës);

“Kontrata individuale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (subjekti i kontratës);

“Letra e kredisë” do të thotë një letër e parevokueshme garancie për kredinë e pagueshme me kërkesë sipas formës dhe përmbajtjes së pëlqyeshme nga pala kërkuese dhe që nxirret nga një institucion financiar tarifa e kredisë së të cilit është të paktën tarifa e specifikuar nga palët (tarifa e kredisë së siguresit mbështetës të kredisë që është bankë);

“Humbjet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(c) (shuma e marrëveshjes financiare);

“Ndryshimi i dëmshëm material” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (ndryshimi i dëmshëm material);

“Arsyeja materiale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.5 (përkufizimi i arsyes materiale);

“Pala që përmbush detyrimet jomospaguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9 (pezullimi i livrimit);

“Opsion” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimit dhe pranimi sipas një opsioni);

“Përfundimi i zakonshëm” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.2 (data e mbarimit të afatit dhe njoftimi 30 ditor i përfundimit);

“OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit;



“OSHEE” do të thotë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

“Pala paguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (pagesat lirë dhe qartë);

“Siguria e performancës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (siguria e performancës);

“Pala marrëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (pagesat lirë dhe qartë);

“Njësia përkatëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (a) (vlerësimi i kredisë);

“Pala kërkuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (vlerësimi i kredisë);

“Programi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 4.2 (përkufizimi i programit) dhe “i programuar” dhe

“Programimi” do të interpretohen sipas kësaj;

“Shitës” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Shuma e marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2 (shuma e marrëveshjes financiare);

“Data e marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Çmimi i marrëveshjes financiare” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale;

“Detyrimi i specifikuar” do të thotë çdo detyrim financiar (aktual ose i ardhshëm, i paparashikuar ose ndryshe, si principal ose garanci ose ndryshe) për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet e pagueshme të filialeve, si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare);

“Vlera neto e prekshme” do të thotë shuma e gjithë kontributeve të paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose në ndonjë llogari tjetër kapitali të njësisë përkatëse e vendosur për qëllimet e njësisë përkatëse dhe çdo fitim i akumuluar pa humbjet e mbajtura të akumuluar dhe asetet e prekshme, përfshirë, por pa u kufizuar me klientelën;

“Taksë” do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobot dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;

“Kapitalizimi total” lidhur me periudhën përkatëse do të thotë shuma e borxhit total dhe gjithë kontributet e paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose ndonjë llogari tjetër kapitali që vendoset për qëllimet e njësisë përkatëse;

“Borxhi total” lidhur me periudhën përkatëse, do të thotë shuma e detyrimit financiar për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet që u paguhen kompanive filiale si dhe instrumentet e borxhit të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Periudha totale e furnizimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë periudha e furnizimit e vendosur mes palëve;

“TVSH” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.1 (TVSH);

“Shkrues” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (livrimi dhe pranimi sipas një opsioni).

VENDIM

Nr. 12, datë 6.2.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA. DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE TË MËDHA ME QËLLIM PLOTËSIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “c” dhe “l”, dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 7 dhe 149 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. “Për miratimin e marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”, si dhe relacionin e paraqitur nga drejtoritë teknike,

Duke konstatuar se:

- Synimet e Modelit të Tregut për ruajtjen e të



gjitha përfitimeve nga burimet hidro për nevoja të klientëve tariforë,

- Marrëveshja bëhet në qëllim të uljes së kostove në sistemin elektroenergjetike,

- Legjislacioni në fuqi nuk reflekton ndryshimet në strukturën pronësore të OSHEE sh.a., e cila duke filluar nga 27.10.2014 operon në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe furnizimit publik me pakicë si një kompani me kapital tërësisht shtetëror.

- Mungesa e rregullimeve në marrëdhëniet KESH sh.a. – OSHEE sh.a. rregullohet përmes kësaj marrëveshje në kuadër të ushtrimit të pushtetit diskrecial nga ERE, i cili vjen si realizim i një qëllimi të ligjshëm siç është ruajtja e përfitimeve hidro për nevoja të klientëve tariforë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për zbatimin e këtij vendimi .

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Nr. 1026/1 prot, datë 06/02/2015Nr. 2614/1 prot, datë 06/02/2015

Drejtuar: Z. Petrit Ahmeti
Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë

Subjekti: Kerkese per miratimin e Marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015

I nderuar Z. Ahmeti,

Bashkëlidhur ju përcjellim për miratim:

Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.

Ligji Nr.9072, date 22.5.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014 "Për Pagesat e Vonuara në Detyrimet Kontraktore e Tregtare", Vendimi Nr.338, datë 19.03.2008, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", i ndryshuar, lutemi të miratoni marrëveshjen e mësipërme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen, me respekt,

Agron HETOJA

Administrator i KESH sh.a.



Ardian ÇELA

Administrator i OSHEE sh.a.



Nr. 1026 prot, datë 06/02 2015Nr. 2614 prot, datë 06/02 2015

Marrëveshje për shit-blejen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015

E lidhur sot me datë 06.02.2015, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, date 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga Z. Agron HETOJA, Administrator i KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "Shitësi",

dhe

OSHEE sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfaqësuar nga Z. Adrian ÇELA, Administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., që më poshtë quhet "Blerësi",

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si "Palët" dhe me vete si "Pala")

Baza ligjore: Ligji Nr.9072, date 22.5.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014 "Për Pagesat e Vonuara në Detyrimet Kontraktore e Tregtare", Vendimi Nr.338, datë 19.03.2008, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", i ndryshuar,

- Në kushtet e krijuara kur mungesa e një marrëdhënie kontraktore me shoqërinë OSHEE sh.a. për shitjen e nga ana e KESH sh.a., të sasive të tepërta të energjisë elektrike ose në rast prurjesh të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në Modelin e Tregut, Rregullat e Shitjes, Rregulloren e Shkarkimit të Plotave dhe atë të Sigurisë së Digave, përtej nevojave të klientëve tariforë është shoqëruar me problematikë serioze për ruajtjen e sigurisë së sistemit elektroenergjetik, uljen e kostove të furnizimit të klientëve tariforë dhe optimizimit energjetik;
- Në kushtet kur shoqëria OSHEE, është shoqëri tashmë me kapital 100% shtetëror, palët gjykohej se ka arritur koha të mundësohet shitja e energjisë elektrike nga KESH sh.a. tek OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes që do të rezultojë në uljen e kostove të përgjithshme në sistemin elektro-energjetik;

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet "Shitësi/Furnizuesi" dhe OSHEE sh.a. që më poshtë do të quhet "Blerësi", lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt për shit-blejen/furnizimin e teprcave të energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në Modelin e Tregut, Rregullat e Shitjes dhe Rregulloren e Shkarkimit të Plotave dhe atë të Sigurisë së Digave, për mbulimin e pjesshëm ose të plotë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.

Neni 2

Detyrimet Kryesore të Palëve

1. OSHEE sh.a., përpara çeljes së procedurës mujore për blerjen në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a. përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike që kjo e fundit mund të shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.

KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha apo dhe teprcave, pasi ka garantuar plotësimin e kërkesës me energji elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë. do të komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e



humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energji elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

2. Nëse të dyja palët bien dakord për furnizimin/lëvrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, lëvrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

Neni 3 Çmimi

Çmimi për lëvrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontratë do të jetë çmimi mesatar mujor i bursës hungareze HUPX për periudhën në të cilën kryhet lëvrimi i energjisë elektrike, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet nga bursa e Hungarisë HUPX (në faqen e internetit: www.hupx.hu)

Neni 4 Faturimi dhe Pagesa

1. Shitësi do t'i lëshojë Blerësit brenda datë 10 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike një faturë ku të pasqyrohet sasia dhe vlera totale e energjisë elektrike të lëvruar gjatë periudhës përkatëse të lëvrimit.
2. Pagesa e faturës nga ana e blerësit, do të bëhet brenda 60 diteve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është Dite Pune, ditën tjetër të punës.
3. Interesi i Mospagesës: Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga Data e Detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përjashtuar datën e pagesës me Përqindje Interesi. Për këtë qëllim Përqindja e Interesit është norma e interesit që do të aplikohet për çdo ditë vonese të pagesës dhe që do të jetë: Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar 8 (tetë) pikë përqindjeje për çdo ditë vonese të llogaritura nga data në të cilën do të kryhej pagesa nga data e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, deri në datën e pagesës së shumës së papaguar të faturës."

Neni 5 Mos-Performanca Për Shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimin të kërkesës për klientët tariforë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontrates do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e lëvrimit ose pranimit; ose
 - b. pezullimi nga OST-ja përkatëse të lëvrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
 - c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes.
 - d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.
2. KESH sh.a. nuk do të shesë/furnizojë energji elektrike për OSHEE sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e kërkesës me energji elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë.
3. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasi të palivruara ose të pamarra.



4. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të lëvrimit.
- 6- Në rast të mos lëvrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslëvruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palëvruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.
- 7- Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfaqësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.

Neni 6

Legjislacioni në Fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontraten do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi dhe i shtrijnë efektet pas miratimit nga ERE.
2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 8

Kjo kontratë nënshkruhet në 5 (pesë) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë nënshkruese të kësaj kontrate dhe një kopje për Entin Rregullator të Energjisë.



Faqe 3 nga 3

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 336 lekë